



RAPORTI I MONITORIMIT AFATMESËM TË AGJENDËS KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE



2021-2022





Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë. Dokumenti është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me ekspertizën dhe asistencën teknike të UNICEF. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas" (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë ato të UNICEF-it në Shqipëri.





RAPORTI I MONITORIMIT
AFATMESËM TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

2021-2022

Korrik 2023

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	10
METODOLOGJIA	12
ZËRI I FËMIJËVE	16
QËLLIMI I. QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE	20
QËLLIMI II. ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS DHE MBROJTJA E FËMIJËVE	27
QËLLIMI III. SISTEMET DHE SHËRBIMET MIQËSORE PËR FËMIJË DHE ADOLESHENTË	39
QËLLIMI IV. PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË BOTËN DIGJITALE	61
PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA	68
REKOMANDIME SPECIFIKE PËR FUSHAT E VEPRIMIT	70
SHTOJCA	74
Shtojca A. Lista e institucioneve të përfshira në raportim	74
Shtojca B. Instrumentet e përdorura	75

SHKURTIME

AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
ASPSKN	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
AMA	Autoriteti i Mediave Audio-vizive
AKDF	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
AP	Avokati i Popullit
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
HPV	Virusi Human Papiloma
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KAP	Kujdestaria Alternative Profesionale
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MD	Ministria e Drejtësisë
MICS	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizatat Jofitimprurëse
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
SHMFF	Shërbimi Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
WVA	World Vision Albania

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 (në vijim referuar si AKDF) synon të krijojë një mjedis të favorshëm për mirëqenien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe zhvillimit në botën digjitale. Impakti social i AKDF-së, pritet të jetë në cilësinë e jetës së fëmijëve e adoleshentëve në familje dhe në çdo kontekst tjetër.

Ky raport paraqet ecurinë e zbatimit të AKDF-së për periudhën 2021-2022, duke analizuar progresin dyvjeçar të punës së institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve të tyre për zbatimin e masave të vendosura. Raporti është strukturuar në mënyrë të tillë që të japë informacion të detajuar për çdo objektiv të AKDF-së, si dhe përmbledhje të informacioneve kryesore në nivel shtyllash strategjike.

AKDF-ja përmbledh një total prej 20 masash, 185 aktiviteteve dhe 20 treguesish strategjikë të rezultateve, që janë parashikuar për realizimin e 9 objektivave specifike, të ndarë sipas katër qëllimeve strategjike:

- i. Qeverisja e mirë për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve.
- ii. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve.
- iii. Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.
- iv. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Masat dhe aktivitetet e parashikuara kanë një natyrë ndërsektoriale për të adresuar nevojat për parandalim, mbrojtje, ndërhyrje afatgjata, ofrimin e shërbimeve miqësore për fëmijët dhe promovimin e të drejtave, duke adresuar normat sociale. Ky raport është hartuar me kontributin e 11 institucioneve shtetërore qendrore përgjegjëse, 7 institucioneve të pavarura, 22 njësi të vetëqeverisjes vendore (NJVV) dhe 7 organizatave të shoqërisë civile (OSHC).

Në Shqipëri, gjatë periudhës së Raportimit, është bërë progres në fushën e të drejtave të fëmijëve, veçanërisht në nivelin legjislativ dhe politik, përmes iniciativave dhe reformave ligjore dhe institucionale, duke i afruar ato me standardet ndërkombëtare.

Mbledhja e të dhënave/statistikave për fëmijët, është shumë e rëndësishme për hartimin dhe monitorimin e politikave. Në vitin 2021, ASHDMF-ja ka bërë publike platformën digjitale për paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse, lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në formën e treguesve (58 tregues specifikë). Për herë të parë, Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 portretizon statistikën e fëmijëve/adoleshentëve dhe të rinjve, si një komponent kryesor i statistikave sociale. Në këtë kuadër është bërë dhe publikimi i rradhës për këta tregues.

Mekanizmat në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve janë shumë të rëndësishëm. Aktualisht, në të gjithë vendin për periudhën raportuese kanë operuar 241 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve (PMF), të cilët janë menaxherë të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin rregullator të fëmijëve. Sipas ASHDMF-së, përgjatë periudhës 2021-2022, janë trajtuar me menaxhim rasti 4,885 fëmijë, ndër të cilët 2,034 fëmijë të trajtuar për herë të parë. Janë identifikuar dhe janë trajtuar si viktima të dhunës seksuale 115 fëmijë.

Për sa i përket mbrojtjes dhe mbështetjes së fëmijëve nga dhuna seksuale, janë ngritur dy qendra me shërbime emergjente për fëmijët viktima/të mbijetuara të abuzimit seksual dhe formave të tjera të rënda të dhunës, në bashkitë Fier dhe Shkodër. Qendrat funksionojnë me standarde për ofrimin e shërbimeve të miratuara për këtë target-grup fëmijësh. Shqipëria ka bërë progres në ofrimin e shërbimeve të specializuara sociale, sa më pranë komunitetit, me fokus fëmijët. Nëpërmjet Fondit Social, një instrument i ri i mbështetjes financiare për nivelin vendor, është mundësuar ngritja e 54 shërbimeve të reja në bashkitë e vendit.

Nga të cilat, 27 shërbime sociale në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në 6 rajone. Reforma e deinstitutionalizimit është shoqëruar me transformimin e shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit alternativ komunitar, ku prioritet kanë patur programet e fuqizimit ekonomik dhe social të familjes së fëmijëve në institucione. Është punuar për transformimin, në dy bashki, të shërbimeve rezidenciale për fëmijë 0-6 vjeç, në dy shërbime të reja komunitare "Fuqizimi fëmijës dhe familjes", nga i cili kanë përfituar 112 familje, për të parandaluar vendosjen në përkujdes rezidencial të fëmijëve.

Bonusi i bebes, ka qenë një politikë sociale e suksesshme në raport me demografinë dhe rritjen e lindshmërisë, duke kontribuar edhe në politikën universale për të gjitha familjet. Mbi 42,000 nëna të reja kanë përfituar nga bonusi i bebes. Për rreth 80,000 fëmijë nga familjet e skemës së ndihmës ekonomike, ofrohet subvencion për nxitjen e arsimimit dhe vaksinimit, kompensim të energjisë elektrike, shërbime shëndetësore falas, si në parësor dhe dytësor, përjashtime nga tarifat në të gjitha fazat e ndjekjes së edukimit dhe përfitime bursash e lehtësira në disa procese. Një mbështetje të posaçme, qeveria shqiptare jep për fëmijët e atyre prindërve, të cilët kanë sakrifikuar jetën e tyre në krye të detyrës duke ndërmarrë një akt vetëmohimi apo patriotizmi, në përpjekje për mbrojtjen e jetës së individit, të mbrojtjes së pronës publike, si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme. Përmes "Fëmijë në Përkujdesje të Republikës", janë mbështetur deri tani 20 fëmijë. Programe të ndryshme zbatohen për përmirësimin e shëndetit të fëmijëve, duke përfshirë kontrollin e syve, kujdesin dentar, imunizimin dhe programet shëndetësore në shkollë. Shërbimet e integruara sociale dhe shëndetësore, ofrohen në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.

156,580 fëmijë kanë përfituar nga Programi Kombëtar për Shikimin. Deri më sot, 235,000 fëmijë kanë përfituar nga programi i kujdesit dentar për fëmijët e moshës 6 deri në 14 vjeç. Nga programi mbarëkombëtar i imunizimit, ku përfshihen 12 lloj vaksinash, përfitojnë të gjithë fëmijët. Programi përfshin edhe vaksinën HPV për vajzat adoleshente. Deri më tani, 2,500 vajza janë vaksinuar me këtë vaksinë, që përbën 80% të popullatës së synuar.

Në kuadër të zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe arsimimit të fëmijëve, shteti shqiptar ka vendosur në funksionim një sërë mekanizmesh me fokus parësor përfshirjen e fëmijëve më të marginalizuar. Mes të tjerave, mund të përmenden rezultate si:


- Krijimi i skemave të mbështetjes financiare në disa bashki për të mundësuar ndjekjen e çerdheve publike nga fëmijët e marginalizuar.
- Ndjekja e klasës përgatitore nga 85% e fëmijëve që shkojnë në klasë të parë.
- Miratimi i Programit dhe Kornizës së vlerësimit të fëmijëve të kopshtit (3-6 vjeç).
- Në vitin arsimor 2021-2022, në sistemin arsimor parauniversitar, ndjekin mësimin në institucione arsimore publike dhe private, duke filluar nga arsimi parashkollor, 4748 nxënës me aftësi të kufizuara (AK). Rreth 78% e fëmijëve me aftësi të kufizuara të regjistruar, ndjekin arsimin bazë, 10% arsimin parashkollor dhe pjesa tjetër arsimin e mesëm të lartë. Raporti i nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special, është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014, në rreth 90% në fund të vitit akademik 2022. Në vitin shkollor 2022-2023, janë të punësuar në sistemin e arsimin parauniversitar 1515 mësues ndihmës. Raporti fëmijë/mësues ndihmës gjatë këtij viti, është 3:1.
- Janë ngritur programe të parandalimit të braktisjes shkollore, duke ulur shifrën e braktisjes për vitin 2021-2022, në 0.62% për arsimin bazë.
- Mbështetja financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet të tjera vulnerabël, ofrohet në zbatim të vendimeve përkatëse të qeverisë. Për vitin shkollor 2021-2022, përfitues të skemës së teksteve falas ishin 280.000 fëmijë nga klasa I deri në klasën IX, përfshirë nxënësit romë dhe egjiptianë. Shkollat që frekuentohen nga nxënës romë dhe egjiptianë, po hartojnë e po zbatojnë programe të veçanta passhkollore si edhe mbështetje pedagogjike për fëmijët jashtë orarit të mësimin. Kjo nismë ka përfshirë rreth 288 shkolla në të gjithë vendin.

Është përmirësuar përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave për Drejtësinë për Fëmijët. Rastet e 1898 fëmijëve në proceset e drejtësisë penale, janë regjistruar brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2022 dhe numri i përdoruesve të rregullt, është rritur me 76%. Këshilli i Lartë Gjyqësor urdhëroi që të gjitha gjykatat të fusin të dhëna në sistem nga viti 2023.

Në zbatim të planit të veprimit të “Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025” AKCESK-u ka kryer disa trajnime dhe fushata sensibilizuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. AKCESK është institucioni i parë që u angazhua për pilotimin e projektit global të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit dhe partneritetit me UNICEF Albania “Krijimi i një mjedisi digjital të sigurt dhe fuqizues për fëmijët”.

37 trajnime (750 pjesëmarrës) janë realizuar në këtë kuadër me aktorët e industrisë, përfaqësues nga institucionet publike në 12 qarqe të vendit. Institucionet kanë raportuar përmes informacionit që kanë dhënë, mbi progresin e realizimit të 13 nga 20 treguesit strategjik¹. Kështu, raportimi në kuadër të treguesve të qëllimeve strategjike, qëndron në nivelin 65%. Prej tyre, rreth 70% janë realizuar ose në proces realizimi.



STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE STRATEGJIKË PËR PERIUdhËN 2021-2022 (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



Të dhënat e grumbulluara nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, japin informacion për 141 aktivitete prej 185 aktiviteteve të parashikuara në AKDF, sipas ndarjes të paraqitur në grafikun e mëposhtëm.

NIVELI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

TË PARAPORTUARA




TË RAPORTUARA

141 aktivitete e raportuara nga institucionet qendrore dhe vendore, janë reflektuar sipas kategorive të mëposhtme të paraqitura në grafikun e mëposhtëm.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE PËR PERIUdhËN 2021-2022 (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)

PLOTËSISHT I REALIZUAR
42%



Sa u përket parashikimeve financiare/buxhetore, raporti analizon shpenzimet faktike të periudhës 2021-2022 dhe synon të analizojë lidhjen që ekziston midis parashikimit të shpenzimeve buxhetore të AKDF-së dhe shpenzimeve faktike të kryera nga

1. Kjo sqarohet në kapitullin e metodologjisë.

burimet e ndryshme të financimit. Kostot treguese janë vlerësuar rreth 613.6 milionë lekë (613 663 274) për periudhën 2021-2022, nga të cilat 21.0% janë identifikuar si hendek financiar. Shpenzimet janë realizuar në masën 75.3% të shpenzimeve të planifikuara për periudhën 2021-2022. Ndër shpenzimet faktike, 41.6% janë mbuluar nga buxheti i shtetit. Shpenzimet faktike janë më të larta në disa objektiva specifike, krahasuar me shpenzimet e planifikuara si p.sh.: në qëllimin II - objektivi II.1 dhe II.2, qëllimin III - objektivi III.2 dhe III.3, si dhe qëllimin IV - objektivi IV.1. Tejkalimi i shpenzimeve për disa nga aktivitetet plotësisht të realizuara në këto objektiva, ka ardhur si rezultat i financimit të një pjese të hendekut financiar të identifikuar në periudhën e planifikimit. Financimi i hendekut financiar, është realizuar kryesisht me fonde të organizatave partnere. Realizimi i shpenzimeve ndryshon sipas objektivave specifike, duke filluar nga 47.0% (në realizim) deri në 104.4% (mbirealizim). Megjithatë, realizimi i përgjithshëm i shpenzimeve është në masën mbi 70.0% në 6 nga 9 objektivat specifike të planit të veprimit.

➤ REKOMANDIMET PRIORITARE

Arritja e një qeverisjeje të mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve kërkon një rol akoma më aktiv të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, për monitorimin dhe zbatimin e AKDF-së, si dhe për advokimin e rritjes së investimeve për fëmijët në vend.

Në vitin 2023, Qeveria e Shqipërisë do të marrë listën e rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, si edhe listën e rekomandimeve nga raportet 'screening' nga BE-ja. Në përgjigje të tyre, do të ishte e nevojshme të hartohen plane veprimi, monitorimi i të cilave duhet të ndiqet me prioritet nga institucionet përgjegjëse.

Është thelbësore rritja e investimeve financiare në të gjithë sektorët, për të realizuar të gjitha të drejtat dhe për çdo fëmijë. Për më tepër, është e nevojshme më shumë mbështetje financiare për të realizuar AKDF-në në vazhdimësi. Ka nevojë për më tepër përpjekje për të fuqizuar institucionet në mbledhjen dhe në raportimin e treguesve për fëmijët sipas fushave të të drejtave, vulnerabiliteteve, gjinisë, grup-

moshës apo të dhëna të tjera që lidhen me etninë dhe arsimin. Statistikat dhe treguesit cilësorë me fokus fëmijët, do të ndihmonin në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin efektiv të të gjithë programeve dhe politikave në nivel qendror dhe vendor. Hartimi i programeve të prindërimit pozitiv, duhet të jetë një nga fokuset kryesore dhe këto programe të integrohen në të gjitha fushat e shërbimeve, duke ofruar manuale dhe trajnime të certifikuara për të gjithë profesionistët në nivel vendor.

Kuadri ligjor ka nevojë të përmirësohet kryesisht për fëmijët e huaj të pashoqëruar dhe të ndarë në territorin e Shqipërisë, duke konsideruar mësimet e nxjerra nga praktikat e zbatuara deri tani dhe nga rekomandimet e analizave ligjore të kryera. Mungojnë standardet për ofrimin e shërbimeve për këtë grup fëmijësh dhe shërbimet e specializuara.

Kodi i Familjes duhet të rishikohet dhe të përfshijë parimin e interesit më të mirë të fëmijës, të integrojë rolin e njësisë të mbrojtjes së fëmijëve, të përcaktojë masat mbrojtëse, të parashikojë deinstitutionalizimin e fëmijës, duke përfshirë kujdesin prindëror dhe përgjegjësinë prindërore dhe të përcaktojë sanksionet për martesën e fëmijëve. Për këtë, institucionet përgjegjëse të interesuara, duhet të përgatisin një raport vlerësimi për të justifikuar ndryshimet e kërkuara dhe ta depozitojnë tek Ministria e Drejtësisë.

Procesi i ndryshimit të Kodit Penal duhet të përfshijë edhe ndryshimet që ndikojnë mbrojtjen më të mirë të fëmijëve. Për këtë, institucionet përgjegjëse të interesuara, duhet të përgatisin një raport vlerësimi për të justifikuar ndryshimet e kërkuara dhe ta depozitojnë tek Ministria e Drejtësisë.

Zbatimi i planit të deinstitutionalizimit, i shtyrë deri në vitin 2023, kërkon angazhimin e pushtetit vendor për të ngritur shërbime të reja (shërbimi mbështetës për fëmijën dhe familjen, kujdesi alternativ profesional) dhe njëkohësisht, mbështetjen në nivel qendror për pilotimin e këtyre modeleve të reja, kostimin e tyre dhe ngritjen e mekanizmave për realizimin e tyre në mënyrë të unifikuar në të gjitha bashkitë (bashkitë ku janë të vendosura IPSH-të dhe jo vetëm).

AKDF-ja 2021-2026, është një dokument i hartuar në emër të qeverisë shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF), me kontributin e ministrive të tjera të linjës, njësisive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

AKDF-ja 2021-2026, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 659, më 3.11.2021. Vizioni i AKDF-së, është krijimi i një mjedisi pozitiv për mirëqenien e fëmijëve përmes aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të të gjitha formave të dhunës dhe zhvillimit digjital.

➤ AKDF-JA U HARTUA NËN VËMENDJEN E DOKUMENTEVE TË MËPOSHTME:

- Raporti i Monitorimit i Agjendës së Fëmijëve 2017-2020;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Raporti periodik i pestë dhe i gjashtë i Shtetit mbi zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës;
- Raporti kombëtar i paraqitur në përputhje me paragrafin 5 të aneksit të rezolutës 16/21 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, Rishikimi Universal Periodik i Shqipërisë;
- Strategjia e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijës;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II).

➤ AKDF-JA PËRCAKTON KATËR QËLLIME STRATEGJIKE:

- Qeverisja e mirë për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e fëmijëve;
- Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve;
- Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët;
- Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Në përputhje me ligjin 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve", MSHMS-ja është institucioni përgjegjës për hartimin dhe monitorimin dhe zbatimin e ecurisë së zbatimit të AKDF-së 2021-2026, mbështetur nga ASHDMF-ja.

Procesi i monitorimit është përcaktuar si detyrim edhe nga VKM-ja nr. 659 (datë 3.11.2021) për miratimin e AKDF-së 2021-2026.

Procesi i monitorimit të AKDF-së u realizua sipas metodologjisë së konfirmuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (IPSIS)", i cili, ndër të tjera, është sistemi kryesor për monitorimin e performancës së arritur kundrejt politikave dhe objektivave të planifikuara në dokumentet strategjike.

MSHMS/ASHDMF-ja, me kontributin e Grupit Ndërinstitucional të Punës, ngritur me urdhrin e

ministrit të MSHMS-së², dhe mbështetjen teknike të UNICEF-it në Shqipëri, realizuan hartimin e raportit të monitorimit afatmesëm të AKDF-së për vitet 2021-2022.

Bazuar në detyrimin ligjor, raporti i monitorimit afatmesëm, i hartuar nga MSHMS/ASHMDF-ja dhe grupi ndërinstitucional, do të paraqitet pranë Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës. Raporti do të paraqitet edhe pranë grupeve të menaxhimit të integruar të politikave dhe komiteteve drejtuese sektoriale. Raporti do të prezantohet edhe pranë grupit parlamentar “Miq të fëmijëve”. Raporti do të jetë publik, i aksesueshëm nga të gjitha palët e interesit.

➤ **RAPORTI AFATMESËM I MONITORIMIT TË AKDF-SË, PARAQET:**

- Statusin e arritjeve/zbatimit të masave të agjendës, që i përkasin periudhës kohore 2021-2022; në nivel objektivash dhe në nivel qëllimesh strategjike;
- Shpenzimet financiare të realizuara, nga buxheti i shtetit dhe partnerët strategjikë;
- Realizimin e treguesve të qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike;
- Reflektimet e fëmijëve mbi realizimin e AKDF-së.

2. Urdhri nr. 519, datë 23 shtator 2020, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2025” i Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Raporti i monitorimit afatmesëm të AKDF-së paraqet analizën e rezultateve të arritura dhe shpenzimeve financiare të kryera për periudhën 2021–2022. Raporti paraqet një pasqyrë të progresit të deritanishëm, si edhe prirjen për zbatimin dhe arritjen e objektivave të vendosura deri në vitin 2026. Në përgjigje të detyrimit për monitorim dhe raportim afatmesëm të AKDF-së, MSHMS-ja e mbështetur nga UNICEF-i në Shqipëri, ndërmoi hapat e mëposhtëm për të realizuar hartimin e këtij raporti:

- Dakordësimi i metodologjisë së hartimit të raportit me Grupin Ndërinstitucional të Punës;
- Hartimi i instrumenteve të përshtatura për çdo institucion raportues për masat/aktivitetet, për mbledhjen e informacionit të detajuar për çdo masë dhe çdo tregues rezultati, duke përfshirë edhe të dhëna buxhetore për periudhën 2021-2022. Këto instrumente morën parasysh instrumentet e IPSIS-it;
- Rishikimi i raporteve e studime të publikuara të lidhura me fushën;
- Konsultimi me fëmijët;
- Hartimi i draftit të parë të raportit të monitorimit afatmesëm të AKDF-së;
- Konsultimi me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse për draftin fillestar;
- Përmbyllja e raportit të monitorimit afatmesëm 2021-2022.

▾ MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI MASAT DHE AKTIVITETET

Për të raportuar mbi zbatimin e masave të parashikuara në AKDF, u hartua një instrument, i cili identifikon të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitet 2021-2022. Instrumenti i kërkon secilit institucion të identifikuar në AKDF të raportojë mbi zbatimin e

masave/aktiviteteve, përfshirë informacionin mbi statusin aktual (deri në dhjetor 2022) të realizimit/zbatimit të aktivitetit, çfarë është realizuar konkretisht, sfidat dhe problematikat e ndeshura gjatë zbatimit, aktorët e përfshirë në zbatim, sugjerime konkrete për rishikimin e planit të aktiviteteve apo për zëvendësimin e aktiviteteve të veçanta me ndërhyrje të reja aty ku është e nevojshme, si edhe informacion mbi shpenzimet e kryera.

Instrumenti lejon që statusi/ecuria e zbatimit të aktivitetit, të raportohet sipas disa kategorive (*i realizuar, pjesërisht i realizuar dhe i përealizuar*).

▾ SFIDAT NË RAPORTIM:

Institucionet qendrore dhe vendore kanë raportuar për zbatimin e masave dhe aktiviteteve në formë të pjesshme duke krijuar vështirësi në paraqitjen reale të statusit të realizimit ose jo të aktiviteteve. Vështirësi më të mëdha janë identifikuar në raportimin në nivel vendor, ku vetëm 22 nga 66 NJVV kanë raportuar informacion. Një pjesë e institucioneve përgjegjëse raportuese, kanë dhënë informacion të përciptë për ecurinë e aktiviteteve, duke mos pasqyruar qasjen ndërsektoriale të realizimit të aktiviteteve, apo qenë transparentë në vështirësitë e ndeshura në përmbushjen e masave.

▾ MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI TREGUESIT

Një instrument i dedikuar mbledhi informacion mbi realizimin e treguesve. Informacioni mbi realizimin e treguesve u grupua sipas: a) rezultatit të treguesve në nivel qëllimesh strategjike; b) rezultatit të treguesve në nivel të objektivave specifike. Informacioni mbi treguesit e aktiviteteve u përfshi në raportimin e ecursisë së aktiviteteve dhe jo më vete.

Në tërësi AKDF-ja përmban 20 tregues të lidhur me 4 qëllimet strategjike dhe 36 tregues në nivel objektivash specifike. Për të mbledhur informacion mbi progresin e arritur të treguesve, u hartuan instrumente të dedikuara për secilin institucion përgjegjës.

Tabela 1. Legjenda e vlerësimit të progresit të zbatimit të aktiviteteve

LEGJENDA	SHPJEGIMI
PLOTËSISHT I REALIZUAR	Objekti i aktivitetit është realizuar plotësisht, siç përcaktohet në planin e veprimit.
PJESËRISHT I REALIZUAR	Objekti i aktivitetit është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100%.
I PAREALIZUAR	Objekti i aktivitetit është realizuar nën shkallën 50%.

Për treguesit, të cilët i kanë të përcaktuara targetet afatmesëm në AKDF, u përcaktua statusi i realizimit, duke marrë parasysh këto kufij: nëse vlera e raportuar është më pak se 30% e targetit, treguesi u konsiderua *i porealizuar*; nëse është 30-80% e targetit, treguesi u konsiderua si *pjesërisht i realizuar*, dhe nëse është mbi 80% u konsiderua *i realizuar*.

➤ SFIDAT NË RAPORTIM:

Një pjesë e mirë e treguesve në AKDF, nuk i kanë të përcaktuara targetet afatmesëm, p.sh., vetëm 8 nga 20 treguesit e objektivave strategjike kanë target realizimi për vitin 2022. Për këta tregues, statusi i realizimit është përlogaritur duke përpjesëtuar targetin e vitit 2026 me vitet e raportimit dhe është përfituar kështu një vlerë e përafërt progresive për targetin vjetor/afatmesëm.

Ka tregues për të cilët raportimi nuk është i mundur, pasi institucionet nuk kanë investuar ende në matjen e tyre. Ata janë kategorizuar si të paraportuar. Për shembull, mes treguesve strategjike, 7 nga 20 prej tyre bëjnë pjesë në këtë kategori, për arsye më poshtë:

- Tre prej treguesve kanë si burim anketa të cilat nuk ndodhin në frekuencë vjetore; kështu, për to, raportimi nuk pritet të ndodhë në këtë fazë raportimi. Këta tregues janë: 1. 'Rezultatet e nxënësve 15-vjeçarë në lexim-shkrim, matematikë dhe shkenca' (burim: PISA/OECD); 2. "Përqindja e fëmijëve (1-14 vjeç), të cilët kanë përjetuar ndëshkim fizik dhe/ose dhunë psikologjike nga prindërit/kujdestarët e tyre";

3. Shkalla e përfundimit të arsimit (për të tria nivelet) (burimi: INSTAT/MICS). Për treguesin e fundit, raportimi do të jetë i mundur me realizimin e MICS-it në vitin 2025.

- Për një tregues, "Fëmijë 0-17 vjeç në qendra rezidenciale me kapacitet maksimal prej 10 fëmijësh", raportimi nuk është i mundur për shkak të mungesës së metodologjisë së dakordësuar nga institucionet përgjegjëse për matjen e tyre.
- Raportimi i treguesve të vdekshmërisë (vdekshmëria neonatale, vdekshmëria foshnjore (nën 1 vjeç) dhe vdekshmëria e fëmijëve nën 5 vjeç), për shkak të rishikimit metodologjik nga institucionet përgjegjëse, e ka bërë të pamundur krahasimin e vlerave aktuale me vitet e mëparshme.
- Për disa tregues, sidomos ato me burim njësitë e vetëqeverisjes vendore, raportimi i plotë ishte i varur nga informacioni i mbledhur nga të gjitha institucionet me detyrim raportimi. Për shkak se vetëm 22 nga 61 NJVV raportuan për këtë raport, u ndeshën vështirësi për pasqyrimin e realizimit të treguesve.
- Për treguesit statistikorë, shifrat për vitin 2022 nga një pjesë e konsiderueshme e institucioneve, nuk janë bërë publike.

➤ MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI SHPENZIMET FINANCIARE

Për raportimin e shpenzimeve, institucioneve përgjegjëse iu kërkua ky informacion:

- Kostot treguese të planit të veprimit (në total dhe të shprehura në përqindje) për secilin aktivitet, masë, objektiv specifik dhe qëllim;
- Shpenzimet faktike, të kryera nga të gjitha burimet e financimit (buxheti i shtetit dhe institucionet/organizatat partnere);
- Shpenzimet e mbuluara deri në fund të vitit 2022 të krahasuara me kostot treguese (të shprehura në përqindje).

Instrumenti i hartuar mundësoi grumbullimin e të dhënave sipas "Udhëzuesit metodologjik për raportet e performancës".

➤ SFIDAT NË RAPORTIM:

Institucionet përgjegjëse hasën vështirësi në raportimin e shpenzimeve faktike për masat dhe veprimtaritë, duke mos raportuar shpenzime faktike, as në total dhe as sipas burimeve të financimit. Për të vlerësuar shpenzimet faktike për masat dhe veprimtaritë plotësisht të realizuara dhe/ose pjesërisht të realizuara, u përdor një metodologji e tërthortë. Shpenzimet faktike u llogaritën dhe u raportuan mbështetur në raportimin mbi ecurinë e aktivitetit, rezultatet e arritura dhe përshkrimin e shpenzimeve (formati IPSIS).

Ecuria e disa aktiviteteve, është raportuar jo vetëm nga institucioni përgjegjës, por dhe nga institucione partnere. Për të rritur saktësinë e raportimit, duhet që informacioni mbi ecurinë e masave dhe shpenzimet, të konsolidohet dhe të raportohet vetëm nga institucioni përgjegjës. Raportimi i së njëjtës veprimtari nga disa institucione, në disa raste krijon mbivendosje dhe mund të shoqërohet me pasaktësi në raportimin e shpenzimeve faktike.

➤ KONSULTIMI ME FËMIJËT

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoritë Arsimore në Bashkitë Sarandë, Kukës, Kamëz, Tiranë, Elbasan, dhe Pukë dhe mbështetjen e UNICEF Shqipëri, Save the Children dhe World Vision udhëhoqi procesin e konsultimit të AKDF-së me fëmijët.

150 vajza dhe djem, të moshës 11-17 vjeç morrën pjesë në disa takime konsultuese, duke iu mundësuar të njohin më mirë dokumentin strategjik, por edhe të reflektojnë mbi qëllimet/objektivat kryesore strategjike më konkretisht dhe të japin kontributin e tyre mbi situatën aktuale, zbatueshmërinë e tyre dhe çfarë duhet bërë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Ky dokument shërbeu si një udhëzues për procesin e konsultimit të planifikuar me fëmijët si pjesë e raportit të monitorimit për zbatueshmërinë e AKDF-së në Shqipëri. Për konsultimin me fëmijët, u ndoq një metodologji e dedikuar dhe e përshtatur me moshën e fëmijëve dhe që respekton interesat e tyre.



Konsultimi i fëmijëve për zbatimin e masave të AKDF-së, ishte një proces i rëndësishëm, informues, vullnetar dhe pjesëmarrës, i realizuar në 6 qytete në shtrirje gjeografike të ndryshme (Sarandë, Kukës dhe Pukë, Kamëz, Tiranë, dhe Elbasan), lehtësuar nga profesionistë në bashkëpunim me ASHDMF-në dhe Drejtoritë Arsimore. Më poshtë jepet një paraqitje e mendimeve të fëmijëve në lidhje me zbatimin e masave të çdo qëllimi strategjik të AKDF-së.

↘ QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Fëmijët shprehën se është me rëndësi të jenë të informuar për të drejtat e tyre dhe të gjitha proceset apo vendimet që ndërmerren për të garantuar zbatimin e tyre. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të fëmijëve, duhet të bëjnë më tepër për të ndarë informacion të përshtatshëm dhe miqësor për moshën e tyre. Fëmijët mendojnë se duhet të krijohen më tepër hapësira miqësore apo mjedise të përshtatshme, ku ata mund të shprehen më lirshëm në lidhje me idetë, të drejtat dhe mundësitë për të raportuar. Fëmijët kërkojnë që të rriturit të njihen me Ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, dhe me Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, si dhe me institucionet që garantojnë zbatimin e tyre dhe monitorojnë realizimin e të drejtave të fëmijëve, të kërkojnë më tepër llogari dhe ta përcjellin këtë informacion tek fëmijët.

“ Fushatat sensibilizuese, të cilat mund të zhvillohen nga vetë fëmijët/nxënësit në bashkëpunim me mësuesit dhe psikologun, në mënyrë që të arrihet një informim dhe ndërgjegjësim më i madh për sa i përket të drejtave tona...”

“ Duhet që të kemi motivim dhe kurajë që të arrijmë qëllimet tona, aktivitetet e krijuara nga bashkia duhet të zgjerohen më tepër, që të ketë një pjesëmarrje më të lartë.”

Fëmijët shprehën se të rriturit duhet të bëjnë më shumë përpjekje për të përfshirë fëmijët në procese vendimmarrëse dhe për t'i bërë pjesëmarrës gjatë zbatimit të propozimeve të tyre, edhe pse ka përpjekje për ngritjen e shërbimeve që nxisin pjesëmarrjen dhe angazhimin e fëmijëve dhe të rinjve.

“ Për sa i përket situatës aktuale në qytetin tonë në Pukë, disa gjëra janë realizuar, për shembull qendra rinore ku të gjithë kemi të drejtë të marrim pjesë, si dhe arsimimi pa dallim feje, krahine, besimi, gjuhe apo race; liria e shprehjes së mendimit pa cenuar të drejtat e të tjerëve”.

Fëmijët shprehën se shpesh, ata nuk e dinë që gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe të dhënies së mendimeve dhe opinioneve në familje, shkollë apo komunitet.

“ Disa gjëra që nuk janë realizuar, është se nuk na kanë përfshirë në disa aktivitete që ka organizuar bashkia, dhe nuk zbatohet e drejta e vendimmarrjes tek fëmijët dhe të rinjtë në qytetin tonë.”

“ Të drejtat të cilat zbatohen në qytetin tonë, janë: E drejta e lirisë, e drejta e fjalës, e drejta e të pasurit një familje, e drejta e emrit. Të drejtat të cilat nuk zbatohen në qytetin tonë, janë: E drejta për të mos u diskriminuar, e drejta për të mos u trafikuar, e drejta për të mos u bullizuar, e drejta e një institucioni të posaçëm për fëmijët me aftësi të kufizuara. Për sa i përket kësaj të fundit, lidhet edhe me të drejtën për të mos u diskriminuar, pasi shumë fëmijë ose nxënës me aftësi të kufizuara ndihen të veçuar nga pjesa tjetër, pasi nuk kanë një institucion të veçantë që të kenë kujdes të plotë dhe të dedikuar.”

➤ ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS DHE MBROJTJA E FËMIJËVE

Prania e formave të ndryshme të dhunës raportohet nga fëmijët, nga një pjesë e mirë e tyre si një fenomen që është i pranishëm dhe për të cilin duhet të flitet më tepër dhe të bëhen më shumë përpjekje për ta pakësuar atë.

“ Në shkollë ka raste që ndeshemi me forma të ndryshme të dhunës, si: dhuna verbale, psikologjike dhe fizike. Në shumicën e rasteve, dhuna verbale ndodh më shumë midis nxënësve, por ka raste që ushtrohet edhe nga mësuesit ndaj nxënësve”

Në rastet kur mësuesi ushtron dhunë ndaj nxënësit, duhet të bëjmë një njoftim të menjëhershëm tek drejtësisht e shkollës në mënyrë që të merren masa.”

“ Dhuna në familje ushqehet nga presioni që prindërit ushqejnë tek fëmijët. Ajo vjen edhe si pasojë e pakënaqësive që prindërit kanë në jetën e tyre të përditshme, të cilat i tregojnë tek fëmijët e tyre.”

“ Kur fëmijët lundrojnë në internet, ata ekspozohen ndaj shumë rreziqeve ku disa prej tyre ndikojnë në gjendjen e tyre morale dhe psikologjike.”

Fëmijët mendojnë se familja, shkolla, komuniteti ku jetojnë, njësia për mbrojtjen e fëmijëve dhe institucione të tjera, duhet të flasin më tepër për dhunën dhe adresojnë më mirë atë nëpërmjet veprimeve konkrete.

“ Pjesa më e madhe e fëmijëve do të dëshironin ndryshime të shumta në ambientet e tyre shkollorë për sa i përket bullizimit, dhunës fizike, diskriminimit, racizmit dhe pabarazisë. Në qoftë se do të kishite ndryshime me hapa të mëdhenj në këto drejtime, fëmijët do të kishin një jetë më paqësore sociale dhe do të ndiheshin më të sigurt në ambientet shkollorë.”

“ Dhuna në familje në ditët e sotme, është mjaft e përhapur si dukuri; Në qoftë se prindërit do të ndryshonin marrëdhëniet e tyre kundrejt fëmijëve të tyre, por gjithashtu ndaj gjithë fëmijëve të tjerë dhe nëse sillen më paqësisht dhe tregohen më të butë me fëmijët e tyre, atëherë fëmijët do të ndiheshin të sigurt dhe do të ruanin kujtime shumë të bukura nga fëmijëria e tyre.”

“ Dhuna në botën digjitale, është një ndër format më të përhapura të dhunës, duke marrë parasysh zhvillimin e vullshëm të teknologjisë dhe efektin që kanë rrjetet sociale tek çdo fëmijë dhe i ri. Nëse prindërit do të kishin dhe do të tregonin më tepër kujdes me fëmijët e tyre dhe do t'u shpjegonin më tepër për botën e internetit, fëmijët do të ishin më kujdesshëm.”
“Bashkia dhe shkolla duhet të marrin masa konkrete për rastet e dhunës të cilësdo formë të jetë ajo”

Fëmijët raportojnë për dinamika shqetësuese marrëdhëniesh mes vetë fëmijëve, të cilat jo gjithmonë identifikohen apo trajtohen nga trupa mësimore.

“ Ne do të donim vende të përshtatshme për fëmijët dhe të dimë ku të drejtohem kur ndihemi të dhunuar.”

“Asnje fëmijë nuk duhet të bullizohet, sidomos ata me aftësi ndryshe.”

Fëmijët shprehën se duhet ndarë më tepër informacion në lidhje me raportimin e formave të ndryshme të dhunës, dhe rolit të gjithsecilit për mbrojtjen e fëmijëve.

“ Të kemi një psikolog funksional në shkollë, që të informohemi mbi tema të ndryshme dhe ku të kemi mundësi të shprehemi.”

“ Ne vetë mund të kontribuojmë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë pjesë në emisione të ndryshme.”

“ Edhe organizatat e ndryshme që merren me të drejtat e fëmijëve, kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e shantazheve, kërcënimeve apo bullizimit online apo çdo forme dhune tjetër”

➤ SISTEMET DHE SHËRBIMET MIQËSORE PËR FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT

Fëmijët treguan gjatë takimeve konsultuese, se kanë nevojë për kushte më të mira të mësimdhënies, me mësues më profesionistë që mbështesin gjithëpërfshirjen dhe mundësi më të mira për fëmijët me aftësi të kufizuara.

“ Në shkollat tona, ne hasim disa probleme, si për shembull vështirësia për të zhvilluar mësimin në klasa kolektive dhe mungesa e laboratorëve, kabineteve informatike dhe fushave sportive. Këto probleme ndoshta nuk janë të tilla për shkollat e qytetit, por për të fshatrave po, dhe ne mendojmë se është e nevojshme, që shkollat e fshatrave ashtu si ato të qyteteve, të kenë të njëjtën infrastrukturë arsimore dhe investime.”

“ Si zgjidhje e problemeve të lartpërmendura, ne mendojmë që duhet të bëhet shkrirja e klasave kolektive, ulja e numrit të nxënësve nëpër klasa, investim në ambientet shkollore, mësues specialistë për orën e Edukimit Fizik, si dhe pajisjen e shkollave me palestra dhe mjete sportive. Besoj se të gjitha shkollat që nuk i kanë këto gjëra, duan t'i kenë dhe duhet t'i kenë.”

“ Ne nuk kemi profesionistë që të na këshillojnë për karrierën tonë.”

Fëmijët shprehën se kanë nevojë që në shkollë të zhvillohen aktivitete që mbështesin edukimin e tyre, përtej orarit mësimor me shumëllojshmëri aktiviteteve.

“ Shkolla ka mungesë aktiviteteve që mund të bëhen pas orarit mësimor.”

“ Për shumë nxënës, do të ishte shumë ndihmuese nëse në shkollë pas mësimit, të zhvillohej program passhkollor për detyrat e shtëpisë apo projekte, ku nxënësit mund të ndihmojnë njëri-tjetrin, por të ketë dhe mësues për të na mbështetur, pasi jo të gjithë fëmijët mund të ndihmohen për detyrat nga prindërit, por edhe vetë mund të kenë vështirësi”. (Pukë)

Hapja e një qendre shëndetësore nëpër shkolla për të ofruar një shërbim multifunksional.

“ Duhet të ketë programe më të mira për fëmijët me aftësi ndryshe të të gjitha moshave.”

Fëmijët theksojnë problemet e dhunës në shkolla. Ata shprehën se shkollat duhet të bëjnë më shumë për të bërë të disponueshëm informacionin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

“ Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese më shpesh nga psikologu dhe punonjësi social, lidhur me informimin e fëmijëve për internetin e sigurt dhe, fushata informimi dhe dhënia e mesazheve sensibilizuese lidhur me dhunën që mund të përjetojnë fëmijët.”

“ Të zhvillohen biseda informuese nga shkolla me prindërit për çështje të përdorimit të rrjeteve sociale, për kontrollin prindëror, për kufirin e moshës dhe për të nxitur bisedimin midis prindërve dhe fëmijëve për çështje që të dyja palët i konsiderojnë si të rëndësishme.”

“ Psikologët dhe punonjësit socialë, mund të bëjnë më shumë orë dhe aktivitete informimi mbi dhunën dhe bullizimin.”
“Trajnimi i punonjësve të policisë”

Fëmijët përshkruajnë varfërinë si arsye kryesore të përjashtimit, mungesës së aksesueshmërisë dhe diskriminimit në shkollë. Ata theksojnë ndikimin e varfërisë që i detyron fëmijët të punojnë dhe, në këtë mënyrë, të largohen nga shkolla, si dhe rrezikun për t'i çuar ata në krim apo sjellje të rrezikshme.

“ Mundësitë për përfshirje në aktivitete të ndryshme nuk janë gjithmonë të njëjta si për një fëmijë që jeton në qytet dhe si për një tjetër që jeton në fshat, sepse mua për shembull, më duhet të marr furgonin dhe ta paguaj vetë që të vij nga shtëpia tek qendra kulturore dhe është diçka që më pengon të zhvilloj një X talent që mund të kem”.

➤ PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË BOTËN DIGJITALE

Fëmijët raportuan se zhvillimi drejt digjitalizimit ka vlera pozitive si: marrja e informacionit, komunikimi me të afërmit, krijimi i projekteve të ndryshme dhe argëtim, por kanë nevojë të informohen dhe të ndërgjegjësohen për pasojat dhe rreziqet e përdorimit të internetit të pasigurt, siç janë: ekspozimi ndaj fotove dhe videove të papërshtatshme, vjedhja e identitetit, kërcënime dhe shantazhe, lojëra të ndryshme të rrezikshme, dhe mosmarrja e masave të nevojshme nga institucionet përkatëse për të rritur sigurinë e fëmijëve në internet.

Fëmijët raportuan disa vështirësi në zbatimin e të drejtës së tyre për zhvillim në botën digjitale:

“ Mungesa e programeve të specializuara kompjuterike për fëmijët në shkollë dhe secili prej nesh duhet me patjetër të ketë një kompjuter apo laptop personal në shtëpi, që të punojë një detyrë të caktuar pasi shkolla nuk na e mundëson këtë gjë.”

“ Mungesa e mësuesve të specializuar për lëndën e TIK.”

“ Më shumë laboratorë të inforatikës nëpër shkolla.”

“ Shumë shpesh po hasim rastet e bullizimit online, ose cyber-bullying ku fëmijët ngacmohen, shahen, tallen nga persona të ndryshëm në rrjetet sociale, por askush nuk na informon apo këshillon si të mbrohemi”.

“ Prindërit duhet të jenë më të informuar, më të kujdesshëm dhe t'u shpjegojnë fëmijëve të tyre mbi rreziqet e botës digjitale, por nga ana tjetër, edhe fëmijët duhet të tregohen më të hapur me prindërit për t'i treguar rastet kur nuk ndihen të sigurt në internet ose rastet kur përjetojnë bullizim online.”

“ Krijimi i hapësirave sportive dhe hapësirave të duhura ku ne mund të shfaqim talentet apo aftësitë tona dhe të organizohen konkurse për këto tema”.

Fëmijët shprehën se duhet të bëhen fushata informuese mbi faqet e palejueshme dhe ato që nuk janë të sigurta për fëmijët, si dhe duhet të zhvillojnë disa aktivitete ndërgjegjësuese lidhur me internetin e sigurt.

AKDF-ja ka si synim përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe sigurimit të të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve, si edhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrjen e institucioneve qendrore dhe vendore.

➤ QËLLIMI 1

QEVERISJA E MIRË NË FUNKSION TË
RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES
SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE




QËLLIMI STRATEGJIK 1 NË SHIFRA

AKDF-ja ka si synim përmirësimin e qeverisjes në funksion të promovimit, respektimit dhe sigurimit të të drejtave të fëmijëve, përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve, si edhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendimmarrjen e institucioneve qendrore dhe vendore.


Institucionet kanë raportuar të gjithë treguesit që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i tyre është i plotë.

a. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)




b. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)

Numri i treguesve	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I porealizuar
4	3	0	1
100%	75%	0%	25%




c. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NR DHE %)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	% e aktiviteteve të raportuara
4	19	12	63%



d. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË RAPORTUARA (NR DHE %)



e. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NR DHE %)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	3	1 265 401	5.3%	1 265 401	100%	91.6%	8.4%
Pjesërisht i realizuar	9	16 241 825	67.6%	15 129 418	93.2%	14.5%	85.5%
I parealizuar	7	6 634 004	27.1%	-	-	-	-

Për të gjithë periudhën 2021-2022 është shpenzuar 68.3% e buxhetit të planifikuar. 20.5% e shpenzimeve të kësaj periudhe, janë mbuluar nga buxheti i institucioneve përgjegjëse dhe 79.5% nga fonde të institucioneve dhe/apo organizatave partnere.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1

INSTITUCIONE DHE MEKANIZMA TË FUQIZUAR NË FUNKSION TË RESPEKTIMIT, MBROJTJES DHE PËRMBUSHJES SË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE (4 MASA DHE 19 AKTIVITETE)

▼ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH SPECIFIKË NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Rritja me 100% e buxhetit vjetor të ASHDMF-së në vitin 2023 (*i parealizuar*);
- Numri i NJVV-ve (të paktën 2) me mekanizma/forume funksionale të përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje/numri i fëmijëve të përshirë – (*i realizuar, Dibër dhe Shkodër*);
- 100% e politikave të planeve qendrore dhe vendore të informuara nga analizat e të dhënave – (*i realizuar nga të gjitha institucionet*);
- Rritja (me 2% në vit) i ankesave dhe i çështjeve të trajtuara nga institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut mbi të drejtat e fëmijëve – (*i realizuar*).

Në vijim, raportimi është organizuar sipas informacionit të mbledhur korrespondues me aktivitetet e listuara në këtë objektiv.

ASHDMF-ja është institucion në varësi të MSHMS-së, e cila bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Buxheti i ASHDMF-së në funksion të këtyre përgjegjësive, është 10 470 000 lekë. Për periudhën 2020-2022

buxheti i ASHDMF-së ka pësuar ulje në vlerë absolute prej 2 000 000 lekësh. ASHDMF-ja vazhdon të ketë një staf prej 7 punonjësish. ASHDMF-ja ka paraqitur dhe ka propozuar një strukturë të re, e cila parashtron nevojën për rritjen e stafit, propozime këto, të cilat pritet të shqyrtohen.

Nën koordinimin e Ministrisë së Evropës dhe Punëve të Jashtme (MEPJ) dhe MSHMS-së, Qeveria Shqiptare ka dorëzuar pranë Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës [përgjigjet mbi listën e pyetjeve](#) që mbulojnë periudhën kohore 2019-2022 në vijim të raportit të Shtetit dorëzuar në vitin 2019.

Ngritja e mekanizmave vendorë për nismën “Bashki mike e fëmijëve” është realizuar në Bashkinë Korçë dhe Dibër, me nënshkrimin e marrëveshjeve midis bashkive dhe UNICEF-it. Bazuar në të dhënat/statistikat dhe në [analizën e situatës së fëmijëve në Bashkinë Korçë](#) është miratuar nga [Këshilli Bashkiak Plani vendor për fëmijët 2023-2025, “Korçë – Bashki mike e fëmijëve”](#). Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet bashkisë së Dibrës dhe UNICEF-it në Shqipëri, është nënshkruar në dhjetor 2022 dhe një proces i ngjashëm do të vijojë me angazhimin e aktorëve lokalë, fëmijëve dhe prindërve edhe në këtë bashki.

Ministria e Mbrojtjes (MM) ka nisur hartimin e dy dokumenteve: 1) Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe 2) Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Ky proces do të përfshijë trajnimin e çështjeve lidhur me efektet e ndryshimeve klimaterike dhe të mjedisit të fëmijët³. Gjithashtu, MM-ja është në procesin e integritimit të njohurive në fushën e mbrojtjes civile në programet

3. Nisma ARSIS me mbështetjen e UNDP-së në kuadër të programit “Masat reaguese për mbrojtjen sociale pas tërmetit”, ka kontribuar në përgatitjen e Planit të Veprimit për përgjigjen ndaj emergjencave për grupet vulnerabël, duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë, Durrës dhe Shijak (2022).

mësimore në sistemin parauniversitar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Bashkia Tiranë, kanë hartuar një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e edukimit mjedisor, në të cilën bën pjesë edhe edukimi mbi ndikimin që sjellin ndryshimet klimatike në jetën e fëmijëve dhe më gjerë. Një [analizë buxhetore](#) është realizuar për të sjellë më tepër informacion mbi trendet në planifikimin dhe realizimin e buxhetit në tre sektorë: arsim, ndihmë sociale dhe shëndetësi. Gjetjet dhe rekomandimet nga analizat e buxhetit, janë përdorur për të advokuar për rritjen e shpenzimeve sociale në seancat vjetore parlamentare për projektligjin e buxhetit 2022 dhe 2023.

INSTAT-i ka publikuar botimin vjetor analitik [“treguesit e mirëqenies për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj 2018-2021”](#). Ndryshe nga publikimet e mëparshme, paraqitja e prirjeve të treguesve ndër vite, e përcjellë përmes grafikëve, shoqërohet me shpjegime përmbledhëse për të mundësuar interpretimin dhe lehtësinë e të kuptuarit të të dhënave. Këta tregues do të luajnë një rol thelbësor në planifikimin dhe monitorimin e politikave kombëtare, si dhe në ndjekjen e progresit të zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe realizimin e arritjeve për integrimin në Bashkimin Evropian.

Për herë të parë, [Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026](#) portretizon statistikën e fëmijëve/adoleshentëve dhe të të rinjve si një komponent kryesor i statistikave sociale. Në këtë program u integrua edhe kryerja e Anketës së Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë (MICS), mbi të cilën u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit (MoU) ndërmjet UNICEF-it dhe INSTAT-it, për të nisur procesin. Po kryhet vlerësimi i hendekut të të dhënave të MICS-it, me qëllim që të përfshihet në

vendimin për shtrirjen/përmbajtjen e MICS 2025. Në vitin 2021, ASHDMF-ja ka bërë publike [platformën digjitale për paraqitjen e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse, lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve në formën e treguesve](#) (58 tregues specifikë për fëmijët)⁴. Nga ana vizuale platforma i pasqyron të dhënat në mënyrë grafike, si dhe paraqet prirjet ndër vite për çdo tregues. Duke njohur sfidat në raportimin e treguesve të ndryshëm, u miratuan ndryshimet e nevojshme përmes VKM-së nr. 471, datë 6.7.2022⁵, dhe tashmë lista e treguesve është 61. Gjatë vitit 2023, platforma do të punohet për të bërë ndryshimet e nevojshme dhe për ta përditësuar me të dhënat e vitit 2022. MSHMS-ja ka forcuar sistemin kombëtar të Sistemit Informativ të Menaxhimit të Mbrojtjes Sociale (MIS) për të profilizuar, synuar, mbështetur, aksesuar dhe monitoruar në mënyrë më efektive përfuturit e programit të shërbimeve sociale. Trajnimi rreth MIS-it i mbi 500 punonjësve të mirëqenies sociale, çoi në rritjen e përdorimit të sistemit në nivel bashkie në regjistrimin, monitorimin dhe raportimin e të dhënave. Pjesëmarrja e fëmijëve sipas raportimeve të institucioneve, njësisive të qeverisjes vendore dhe organizatave, është realizuar në pjesën më të madhe në kuadër të zbatimit të programeve nga organizatat nëpërmjet angazhimit të qeverisë së nxënësve, grupeve rinore dhe grupit të fëmijëve dhe parlamentin rinor⁶.

[Platforma U-Report](#), një formë novatore për zgjerimin dhe përdorimin e teknologjisë digjitale për të realizuar të drejtat e fëmijëve dhe të të rinjve në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar për të ngritur zërin për çështje që i prekin nga afër *on-line* dhe *off-line*, është konsoliduar dhe vijon aktivitetet për ta promovuar atë si një mjet kryesor për të çuar zërin e të rinjve në nivel vendimmarrës. U-Report-i është bërë një mjet kryesor në zhvillimin e politikave, si për strategjinë për të rinjtë, ndotjen e ajrit, thirrjen e veprimit në Samitin e Transformimit të Arsimit etj.

4. Vendimi nr. 636, datë 26.10.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDMF-ja, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

5. Vendimi nr. 471, datë 6.7.2022, “Për një ndryshim në vendimin nr. 636, datë 26.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore, të kërkuara nga ASHDMF-ja, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”.

6. World Vision ka raportuar se përgjatë periudhës 2021-2022, janë përfshirë 1 381 fëmijë dhe adoleshentë në sesione trajnimi dhe rritje kapaciteti për qytetarinë aktive dhe advokaci, duke nxitur mendimin kritik. 70 adoleshentë janë trajnuar në vitin 2022 për aftësim digjital dhe aftësitë e shek. XXI (komunikim, novacion, mendim kritik etj.), si edhe për përdorimin e teknologjisë për qëllime advokacie. CRCA/ECPAT Shqipëri, mbështeti Grupin e Fëmijëve dhe Parlamentin Rinor, që të kontribuojnë në përgatitjen e Raportit Alternativ për të Drejtat e Fëmijës, si dhe ta prezantojnë atë përpara Komitetit DF në Gjenevë.

7. Me mbështetjen e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve/UNICEF Shqipëri u angazhuan 360 të rinj në mënyrë aktive në hartimin e sondazheve dhe diskutimet e komenteve pas sondazheve, 10 000 të rinj u arritën përmes aktiviteteve të ndryshme informuese dhe promovuese të organizuara nga U-reporters.

Avokati i Popullit finalizoi [Raportin e vlerësimit të ndikimit të të drejtave të fëmijëve masat e reagimit ndaj COVID-19](#), me mbështetjen e UNICEF-it dhe Rrjetit Evropian të Avokatëve të Popullit për Fëmijët. Gjetjet dhe rekomandimet u lançuan në fund të vitit 2022 dhe për zbatimin e tyre u kërkuar angazhimi i të gjithë aktorëve përgjegjës. Avokati i popullit (Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve) përgjatë vitit 2021-2022 ka trajtuar 449 ankesa/kërkesa, ndër të cilat 194 ankesa/kërkesa të ardhura nga vetë fëmijët dhe 89 ankesa/kërkesa në emër të fëmijëve dhe 166 ankesa/kërkesa të trajtuara me nisma si dhe inspektive, me objekt të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve sipas burimit të ngritjes së ankesës/kërkesës (nga fëmija, në emër të fëmijës, me nismën e AP-së) dhe statusit të menaxhimit të rastit (në proces / i mbyllur). Përgjatë dy viteve nga 449 ankesa/kërkesa gjithsej, 203 ankesa/kërkesa janë në proces shqyrtimi dhe 146 ankesa/kërkesa janë mbyllur.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) ka përfunduar shqyrtimin e 8 çështjeve, në të cilat janë trajtuar problematikat e fëmijëve, ndërsa përgjatë vitit 2022, KMD-ja ka trajtuar 6 çështje, në të cilat fëmijët kanë qenë subjekt i ankesave. Të gjitha çështjet e trajtuara nga Komisioneri gjatë kësaj periudhe, kanë pasur të bëjnë me ndjekjen e arsimit nga ana e fëmijëve. Komisioneri, në përfundim të trajtimit të tyre, ka dalë me 3 vendime diskriminimi, 1 vendim mospranimi dhe 1 vendim arritjeje efektiviteti.

Gjatë muajit prill 2022 Grupi i Deputetëve “Miq të fëmijëve”, zhvilloi seancën dëgjimore me të rinjtë e shkollës së mesme “Raqi Qirinxhi”, Korçë, të cilët prezantuan përpara Kryetares së Kuvendit, deputetëve e pjesëmarrësve, peticionin e tyre, i cili kishte si objekt forcimin e kontrollit parlamentar dhe marrjen e masave me natyrë legjislative (nëse është nevoja) për të rritur përpjekjet për parandalimin e krimeve seksuale ndaj të miturve në vendin tonë. Në vijim të këtij takimi, Grupi i Deputetëve “Miq të fëmijëve”, në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit, zhvilloi në datën 28.9.2022 seancën dëgjimore me temë: “Të rinjtë aktivë adresojnë zërin e tyre në Kuvend” me përfaqësues të gjimnazeve të tjera në Shqipëri. Në 4.7.2022 Grupi i Deputetëve “Miq të Fëmijëve”, zhvilluan seancën dëgjimore për fëmijët e huaj të pashoqëruar më qëllim trajnimin e vështirësive të përgjigjes ndaj nevojave të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me UNICEF dhe UNHCR. Në kuadër të mirërritjes dhe miredukimit të fëmijëve, gjatë vitit 2022, ka zhvilluar edhe një program për aktivitete jashtëshkollore, të cilat do të zbatohen në 200 shkolla nëpër të gjithë vendin, duke filluar nga janari 2023. Ky është një program, i cili synon të ofrojë kurse jashtëshkollore në 5 disiplina të ndryshme për fëmijët dhe të rinjtë në disipinat: arte, zeje, agrikulturë, mjedis, sport, dhe teknologji informacioni. Kjo do të sjellë edhe zbatimin dhe zhvillimin e njohurive të fëmijëve dhe në fushën e turizmit.

Tabela 2. Paraqitje e ankesave në nivel vjetor nga Avokati i Popullit

Total	Burimi i ngritjes së ankesës		
	Ankesa/Kërkesa nga vetë fëmijët	Ankesa/Kërkesa në emër të fëmijëve	Raste me iniciativë të trajtuara dhe inspektive
226 (viti 2021)	102	37	87
223 (viti 2022)	92	52	79


Tabela 3. Paraqitje e ankesave në nivel vjetor nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)

TOTALI	Burimi i ankesës			Fusha ku pretendohet diskriminimi		
	Nga fëmija/ët	Në emër të fëmijës/ve	Nga Komisioneri	Arsim	Të mira	Shërbime
8 (2021)	0	8	0	5	0	3
6 (2022)		4	2		4	2

STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



PARTNERËT E ANGAZHUAR

Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, INSTAT-i, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF-i, UNDP-i, Save the Children, World Vision-i, Terre des Hommes, Nisma ARSIS, CRCA/ECPAT, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të të Rinjve, Edu-Innovation.

SHPENZIMET FINANCIARE

Shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti, janë llogaritur mbështetur në kostot treguese. Si burime financimi, janë konsideruar ato që janë identifikuar në planin e veprimit. Sipas planit të veprimit, rezultojnë të mbulonte 85.5% të kostove treguese, ndërsa 14.5% është konsideruar hendek financiar. Institucionet përgjegjëse nuk kanë raportuar shpenzime për aktivitetet e raportuara si plotësisht të realizuara dhe pjesërisht të realizuara. Mbështetur në informacionin e ofruar nga institucionet mbi realizimin e aktiviteve, realizimin e treguesve dhe përshkrimin e shpenzimeve në llogaritjen e kostove treguese, është bërë një vlerësim i përafërt i shpenzimeve. Nga ky vlerësim rezultojnë që për vitin financiar 2021, është shpenzuar vetëm 55.8% e shpenzimeve të planifikuara, ndërsa për vitin 2022, ky tregues është arritur në masën 75.0%. Për të gjithë periudhën 2021-2022, është shpenzuar 68.3% e buxhetit të planifikuar. Ndërkohë, mbështetur në burimet e financimit rezultojnë që 20.5% e shpenzimeve të kësaj periudhe, janë mbuluar nga buxheti i institucioneve përgjegjëse dhe 79.5% nga fonde të institucioneve dhe/apo organizatave partnere. Përmes burimeve nga organizata partnere, është financuar 69.2% e hendekut të identifikuar gjatë planifikimit të burimeve të financimit.

Tabela 4. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi	Numri i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	3	1 265 401	5.3%	1 265 401	100%	91.6%	8.4%
Pjesërisht i realizuar	9	16 241 825	67.6%	15 129 418	93.2%	14.5%	85.5%
I parealizuar	7	6 634 ,004	27.1%	-	-	-	-

➤ QËLLIMI 2

ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS DHE MBROJTJA E FËMIJËVE



QËLLIMI STRATEGJIK 2 NË SHIFRA

Qëllimi II ka adresuar eliminimin e të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë rritjen e fëmijëve në një mjedis mbështetës me praktika pozitive të prindërimit, që i mbron nga dhuna dhe abuzimi. Ky qëllim ka në vëmendje funksionimin e një sistemi të dobishëm dhe gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet përmirësimit të kuadrit normativ, buxhetor dhe raportues për mbrojtjen e fëmijës dhe fuqizimit të kapaciteteve të mekanizmave dhe shërbimeve për trajnimin e dhunës ndaj fëmijëve.

Ky qëllim ka priorizuar ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave dhe shërbimeve të veçanta dhe të integruara për trajnimin e formave më të rënda të dhunës, përfshirë abuzimin seksual, abuzimin dhe shfrytëzimin *on-line*.

Institucionet kanë raportuar për 78% të treguesve që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i vetëm 12% prej tyre është mundësuar plotësisht.

a. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)



NUMRI I TREGUESVE GJITHSEJ


b. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)

Numri i treguesve	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I porealizuar
9	1	4	4
100%	12%	144%	44%




c. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NR DHE %)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	% e aktiviteteve të raportuara
4	51	41	80%



d. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË RAPORTUARA (NR DHE %)



e. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NR DHE %)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	16	33 624 439	31.21%	37 910 384	112.75%	3.45%	96.55%
Pjesërisht i realizuar	10	46 169 684	42.85%	33 907 940	73.44%	49.90%	50.10%
I porealizuar	16	19 097 058	17.72%	-			
Pa info	9	8 856 926	8.22%				

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1

FËMIJËT RRIEN NË NJË MJEDIS MBËSHTETËS, ME PRAKTIKA POZITIVE TË PRINDËRIMIT, QË I MBROJNË NGA DHUNA DHE ABUZIMI

▾ TREGUESI NË NIVEL OBJEKTIVI STRATEGJIK:

Njohuritë, qëndrimet dhe praktikat pozitive të prindërve/kujdestarëve në kuadër të parandalimit dhe trajnimit të dhunës (*pjesërisht i realizuar*).

Përmes mbështetjes së UNICEF-it, është realizuar vala e parë e anketës për të matur njohuritë dhe qëndrimet e publikut rreth dhunës ndaj fëmijëve. Publikimi do të realizohet në vitin 2023, duke përcaktuar kështu edhe metodologjinë krahasuese për një anketë në vitin 2026.

E kthyer tashmë në një traditë, përgjatë tetorit të cilësuar si “muaji i luftës kundër trafikimit të personave”, Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe organizatat partnere, ka organizuar në 12 qarqet e vendit aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e trafikimit të personave, përfshirë fëmijët.

Bazuar në kalendarin kombëtar të antitrafikut, veprimtaritë përgjatë këtij muaji u përqendruan kryesisht në ekspozita me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare; forume diskutimi në nivel lokal për problematikat e trafikimit; aktivitete sensibilizuese për trafikimin e fëmijëve me përfaqësues lokalë, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme; programe televizive në televizione kombëtare dhe lokale; marshime sensibilizuese në kryeqytet dhe në qendrat e qarqeve; shpërndarje e materialeve ndërgjegjësuere, kuti dhe tenda informuese, etj.

Në zbatim të detyrave dhe objektivave që ka Autoriteti i Mediave Audio-vizive në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit Kundër Trafikimit të Personave (2021-2023); bazuar në kërkesat e ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audio-vizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (konkretisht të parashikuara specifikisht në nenet: 19, pika 2/c, ç, dh; neni 23, pika 1/ç dhe neni 29 pika 2); si dhe referuar buxhetit të institucionit për vitin 2022, është publikuar për herë të tretë thirrja për realizimin e një projekti me dy komponentë, si më poshtë vijon:

- Komponenti i parë: “Trajtimi në median audio-vizive i rasteve të trafikimit të personave, si dhe respektimi e garantimi i ruajtjes së jetës private të viktimave të trafikimit, veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël” (fokusi në qarqet Elbasan, Korçë, Fier, Gjirokastrë, Berat dhe Vlorë);
- Komponenti i dytë: “Trajtimi në median audio-vizive i rasteve të trafikimit të personave, si dhe respektimi dhe garantimi i ruajtjes së jetës private të viktimave të trafikimit, veçanërisht të fëmijëve, si kategoria më vulnerabël” (fokusi në qarqet Durrës, Lezhë, Shkodër, Dibër dhe Kukës).

Përgjatë vitit 2021-2022, moduli i edukimit për prindërimin pozitiv, është hartuar për profesionistët pranë qendrave të shërbimeve mbështetëse për fëmijën dhe familjen në dy bashkitë-pilot në kuadër të procesit të transformimit të institucioneve të përkujdesit shoqëror në shërbime komunitare dhe për të mbështetur procesin e ribashkimit të fëmijës me familjen në dy bashki, në atë të Korçës dhe të Vlorës, nën monitorimin e Shërbimit Social Shtetëror.

Gjatë vitit 2022, CRCA/ECPAT Shqipëri, punoi me mbështetjen e UNDP-së për përgatitjen e “Modelit të shërbimeve për fuqizimin e familjes që përballet me rast të dhunës seksuale ndaj fëmijëve”. Moduli dhe programi i plotë, do të prezantohet gjatë tremujorit të parë të vitit 2023.

Gjatë vitit 2021–2022 janë bërë pjesë e trajnimeve mbi prindërimin pozitiv nga Terre des Hommes 922 persona. WVA-ja ka zbatuar projektin “Në labirint”, i cili targeton ndërgjegjësimin e popullatës së gjerë, sidomos të prindërve, për çështjen e dhunës ndaj fëmijëve. Gjatë vitit 2021 e kanë vizituar “Labirintin” rreth 4836 individë gjithsej, ndërsa në vitin 2022 këtë instalacion e kanë vizituar 1487 individë.

Shoqata Nisma ARSIS, me mbështetjen e UNICEF Shqipëri, ka hartuar programin e prindërimit “Jam këtu për ty”, me qëllimin final reduktimin e rrezikut të abuzimit dhe ndarjes së fëmijëve nga familja shkakuar nga emergjencat në Shqipëri. Qëllimi i këtij programi, është të ndihmojë familjet në përballimin e sfidave të jetës së përditshme dhe ngjarjeve të pazakonta dhe të papritura, duke reduktuar impaktin që të gjitha këto mund të kenë në shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe familjes.

Janë përgatitur disa materiale mbështetëse në formën e broshurave, me qëllim edukimin dhe ndërgjegjësimin mbi të gjitha format e dhunës, abuzimit, trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve.

Gjithashtu, “Konventa e të Drejtave të Fëmijëve” është publikuar në një format të përshtatshëm për fëmijë, me gjuhë miqësore, shoqëruar me ilustrime të personazheve të filmave vizatimorë. Në gjuhën angleze janë përgatitur broshura për informimin e shtetasve afganë të akomoduar në Shqipëri mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, formave të dhunës dhe mënyrës së raportimit dhe të referimit.


Në 27 njësitë administrative në Bashkinë Tiranë, në disa nga qendrat komunitare, janë ngritur dhe funksionojnë klubet e prindërimit (mbi disiplinën pozitive, mbi përgjegjësitë e përbashkëta dhe të barabarta të nënave dhe baballarëve kundrejt fëmijëve, për rritjen e fëmijëve të lirë nga stereotipat gjinorë dhe edukimin e tyre mbi vlerat e barazisë gjinore të përshtatshme për të gjitha grup-moshat).

Moduli i trajnimit të prindërve në bazë të zonave në të cilat operojnë, është zhvilluar nga Fshatrat SOS, Nisma ARSIS, Save the Children dhe WVA-ja.

STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi strategjik II përfshin tri objektiva specifike. Objektivi specifik II.1 ka vetëm një masë me gjashtë aktivitete, nga të cilat dy janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezulton që buxheti i planifikuar për katër aktivitetet e tjera të objektivit specifik, duhej të mbulonte 78.3% të kostove treguese për periudhën 2021-2022.

Sipas vlerësimit të bërë, rezulton që për vitin financiar 2021 nuk ka pasur shpenzime të planifikuara, pra, për rrjedhojë, nuk janë pasqyruar as shpenzime faktike. Ndërsa për vitin 2022, shpenzimet faktike janë realizuar në masën 104.4%, pasi është financuar një pjesë e hendekut financiar. Për të gjithë periudhën 2021-2022 është shpenzuar 81.7% e kostove treguese. 99.5% e shpenzimeve janë mbuluar nga fonde të donatorëve dhe/apo organizatave partnere. Përmes burimeve nga organizatat partnere, është financuar 25.0% e hendekut financiar të identifikuar gjatë hartimit të planit.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Brendshme, Autoriteti i Medias Audio-vizive, si dhe organizma ndërkombëtarë që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve – UNICEF-i, Terre des Hommes, World Vision-i Albania, Nisma ARSIS, Save the Children, CRCA/ECPAT.

Tabela 5. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	2	424 507	2.7%	424 507	100%	19.4%	80.6%
Pjesërisht i realizuar	2	14 760 000	95.1%	15 780 000	104.4%	0.0%	100.0%
I parealizuar	2	330 028	2.1%	-			

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2

FUNKSIONIMI I NJË SISTEMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE TË DOBISHËM PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Numri i akteve normative të hartuara/rishikuara (të paktën 2 në vit), në konsultim me grupet e interesit dhe fëmijët, dhe në linjë me standardet ndërkombëtare *(pjesërisht i realizuar)*;
- Përqindja e NJVV-ve që kanë linjë të veçantë të buxhetit për menaxhimin e rasteve të dhunës së fëmijëve – *(i parrealizuar)*;
- Përqindja e NJVV-ve me struktura të kualifikuara për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me kërkesat e legjislacionit të rishikuar – *(i paraportuar)*;
- Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të punësuar – *(pjesërisht i realizuar, nga 236 në 241)*;
- Numri në rritje (5% çdo vit) i fëmijëve të identifikuar në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, rastet e të cilave janë menaxhuar gjatë vitit nga NJMF/PMF – *(i realizuar)*;
- Numri në rritje (5% çdo vit) i fëmijëve, për të cilët është marrë vendimi për dhënien e masës mbrojtëse nga gjykata – *(i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve (2% rritje çdo vit) që kanë raportuar një formë dhune, të regjistruar nga institucionet arsimore – *(pjesërisht i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve viktime të dhunës, regjistruar nga institucionet shëndetësore i paraportuar.

Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i përafër me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (GDPR), është dërguar pranë shërbimeve të Komisionit Evropian më datë 31.10.2022 nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, dhe ndërkohë vijon puna për vlerësimin e komenteve të përcjella gjatë fazës së bashkërendimit. Më datë 28.12.2022, Komisioni Evropian ka përcjellë komentet mbi projektligjin, të cilat janë duke u vlerësuar nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Zyrën e Komisionerit. Disa nga risitë e projektligjit, veçanërisht në lidhje me fëmijët në cilësinë e subjektit të të dhënave, janë:

- Zgjerohet gama e të drejtave të subjektit të të dhënave dhe, në të njëjtën kohë, forcohen masat e garantimit të tyre, duke i dhënë qytetarit kontroll më të lartë mbi të dhënat personale. Në këtë kuadër, e drejta për informim përmirësohet duke siguruar që informacioni i kërkuar nga subjekti i të dhënave të jepet nga kontrolluesi në një formë të saktë, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, veçanërisht kur informacioni u drejtohet fëmijëve;
- Forcohen kriteret për dhënien dhe vlefshmërinë e pëlqimit të subjektit të të dhënave, duke përfshirë trajtimin e aspekteve praktike për dhënien e pëlqimit nga fëmija, si dhe pëlqimin me mjete elektronike.

Në vitin 2021 me VKM-në nr. 670, datë 10.11.2021, u miratua Plani Kombëtar i Veprimtimit për Luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023. Plani shpreh përkushtimin e qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore dhe të aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave. Qëllimi i këtij plani kombëtar, është sigurimi i angazhimit dhe përkushtimit të të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, për të luftuar trafikimin e personave, për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe të grupeve vulnerabël nga trafikimi, nëpërmjet marrjes së masave efektive ligjore ndaj

autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjes e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht fëmijëve e grave. Kriteret e cilësisë së punës së strukturave për mbrojtjen e fëmijëve, grupe teknike janë hartuar nga ASHDMF-ja, me mbështetjen e UNICEF-it përgjatë vitit 2022 dhe është në proces hartimi i metodologjisë për matjen dhe mbikëqyrjen e tyre. Të dy këto materiale do të miratohen me akt normativ si një dokument i vetëm. Gjithashtu është mbështetur trajnimi *online* i 110 punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve mbi procedurat e vlerësimit të rrezikut të fëmijëve, rrugët e referimit të menaxhimit të rasteve dhe vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijëve. Bashkia Tiranë, me mbështetjen e Terre des Hommes, ka filluar në nëntor 2022 të hartojë metodologjinë e kostimit të Planit Individual të Mbrojtjes për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve për menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Mekanizmat në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, janë shumë të rëndësishëm. Aktualisht, në të gjithë vendin, kemi 241 punonjës të mbrojtjes së fëmijëve (PMF), të cilët janë menaxherë të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, sipas procedurave të përcaktuara në kuadrin rregullator të fëmijëve.

Sipas ASHDMF-së, përgjatë periudhës 2021-2022 janë trajtuar me menaxhim rasti 4885 fëmijë, ndër të cilët 2034 fëmijë të trajtuar për herë të parë. 115 fëmijë janë identifikuar dhe janë trajtuar si viktima të dhunës seksuale. MSHMS-ja, në kuadër të angazhimit të vazhduar dhe përmbushjes së të gjitha proceduarve në zbatim të ligjit nr. 163/2014, "Për Urdhrin e Punonjësve Socialë të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ka ngritur Urdhrin e Punonjës Social. Mbështetja e Urdhrit të Punonjës Social, çoi në regjistrimin dhe licensimin e 1000 punonjësve. Një paketë instrumentesh u zhvillua për të pasuruar njohuritë, për të ndërtuar ndërgjegjësimin gjinor dhe aftësitë e punonjësve socialë për të punuar me të rinjtë në situata të vështira dhe do të përdoret për të trajnuar punonjës socialë. Përgjatë vitit 2021-2022, punonjës nga sektorë të ndryshëm janë trajnuar dhe janë përmirësuar kapacitetet duke ndikuar në përmirësimin e mekanizmit të identifikimit, raportimit dhe referimit të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve në nevojë për mbrojtje. 80 punonjës policie janë trajnuar për teknikat shkencore të intervistimit të të miturve në kontakt me policinë, si dhe janë zhvilluar takime me

Drejtorinë Vendore të Policisë për Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, me mbështetjen e UNICEF Shqipëri. Gjatë periudhës 14-17 maj dhe 12-14 tetor 2022, Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Policinë, Gjykatat, Prokurorinë dhe Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ka organizuar trajnimin me tematikë "Hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i rasteve të trafikimit të personave përmes një qasjeje të përqendruar te viktima". Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin përfaqësues të policisë antitrafik, prokurorë, gjyqtarë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, avokatë të viktimave të trafikimit dhe përfaqësues të mbrojtjes së fëmijëve. Si pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare së Arsimit 2021-2026, janë parashikuar masa dhe veprimtari, të cilat synojnë parandalimin dhe trajnimin e çdo lloj dhune dhe abuzimi në shkollë. Nga shtatë kompetencat kyçe, dy prej tyre "kompetenca personale" dhe "kompetenca qytetare", orientohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga edukimi për parandalimin e dhunës nëpërmjet ndryshimit të sjelljes dhe qëndrimeve në shkollë dhe në komunitet, si dhe për barazinë gjinore. Institucionet arsimore parauniversitare, kanë ngritur sistemin e identifikimit, të parandalimit dhe të raportimit të dhunës, bullizimit dhe ekstremizmit në shkollë. Punonjësit e shërbimit psiko-social në institucionet arsimore, ndërmarrin fushata të ndryshme informimi dhe ndërgjegjësimi për parandalimin e dukurisë së dhunës në shkollë dhe jashtë shkolle, në të gjitha format e saj.

Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje, krijohet pranë çdo bashkie me njësinë e mbrojtjes së fëmijës dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës. Për të parandaluar dhunën, është miratuar edhe udhëzimi nr. 23, datë 1.12.2021, "Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e Portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar, ku citohet: "Nuk mund të aplikojnë për konkurrim për të punuar si mësues, pavarësisht faktit të rehabilitimit, të gjithë personat që janë dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepe penale kundrejt të miturve; ata që janë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepe penale që lidhet me institucionet arsimore". Shtimi i numrit të oficerëve të sigurisë në shkollë, është

rregulluar me bazë ligjore sipas VKM-së nr. 553, datë 29.7.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 600, datë 9.10.2018, "Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriteve për oficerët e sigurisë", i ndryshuar. Nga 150, numri i oficerëve të sigurisë në fund të vitit 2022 ka arritur në 220. Oficerët e sigurisë janë punësuar edhe në shkollat 9-vjeçare që kanë të paktën 700 nxënës. Oficerët e sigurisë trajnohen dhe certifikohen nga Akademia e Sigurisë. Rreth 140 oficerë sigurie janë trajnuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP). Përgjatë vitit 2022 është shtuar numri i punonjësve në shërbimin psiko-social, ku një psikolog mbulon 300-499 nxënës. Aktualisht, të gjitha institucionet arsimore në vend, janë të mbuluara me punonjës të shërbimit psiko-social. MAS-i ka miratuar urdhrin nr. 483, datë 1.12.2021, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e programit për rritjen e sigurisë në internet dhe parandalimin e fenomeneve negative në shkollë", që përbën një nga masat e ndërmarra për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet. Në vitin 2022, për të mbështetur protokollin e punës së punonjësve psiko-socialë, me qëllim rritjen e cilësisë së këtij shërbimi për të gjithë nxënësit, janë hartuar dhe miratuar: "Standardet e përgjithshme profesionale të shërbimit psiko-social shkollor", "Parimet për etikën profesionale të shërbimit psiko-social shkollor" dhe "Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor". Për parandalimin e dhunës në shkollë, me një fokus të veçantë në ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljes së stafit arsimor, prindërve dhe nxënësve, është zhvilluar një metodologji e re për trajnimin e mësuesve (Ndërhyrjet e sjelljes pozitive në shkollë), që u ofron mësuesve qasje të reja të menaxhimit të klasës; është hartuar një udhëzues për shkollat dhe mësuesit "Ndërhyrjet për sjelljet pozitive". Janë ngritur kapacitetet e rreth 600 mësuesve nga Berati, Lezha, Tirana dhe Korça për metodologjinë e ndërhyrjeve pozitive të sjelljes me synim parandalimin e dhunës në shkollë.

Gjatë vitit 2021, ALO 116111 ka pritur 29.957 telefonata, nga të cilat janë trajtuar 3271 raste/çështje përmes këshillim-mbështetjes psikologjike, vlerësimit, si dhe referimit të shërbimit ekzistues të integruara/mbështetëse. Ndërsa përgjatë vitit 2022, ALO 116111 ka pritur 28.812 telefonata, nga të cilat janë trajtuar 2166 raste/çështje përmes këshillim-

mbështetjes psikologjike, vlerësimit, si dhe referimit të shërbimit ekzistues të integruara/mbështetëse. Përgjatë vitit 2021-2022, bazuar në kategorinë më dominuese të problematikave të referuara pranë ALO 116 111, atë të shfrytëzimit për arsye përfitimi, vlen të theksohet se 738 raste lidhen me fëmijë në situatë rruge, që shfrytëzohen për lypje (respektivisht 540 raste përgjatë vitit 2021 dhe 198 raste përgjatë vitit 2022). UNICEF-i me fondacionin Together Albania, dha mbështetje psikologjike për 958 fëmijë dhe të rinj, nga të cilët 83 fëmijë u referuan në shërbime të specializuara terapeutike.


Nën koordinimin e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe mbështetjen e UNICEF-it dhe Terre des Hommes, shërbimi i emergjencës *ad-hoc* për pritjen dhe akomodimin afatshkurtër të rasteve të fëmijëve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit, është ofruar nga një ekip punonjësish të ndryshëm për grupe të ndryshme fëmijësh, me pak eksperiencë profesionale për trajtimin e fëmijëve dhe nënave të tyre nga zonat e konfliktit, role dhe përgjegjësi të paqarta institucionale, si dhe paqartësi legjislative.

37 përfitues (28 fëmijë dhe 9 gra) janë mbështetur me plotësimin e nevojave bazike dhe psiko-sociale përgjatë procesit të rehabilitimit. Përgjatë vitit 2022 janë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit për rehabilitimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit.


Nisma ARSIS, me mbështetjen e UNICEF-it, gjatë periudhës 2021-2022, ka ofruar Shërbimin e Strehimit Emergjent të Sigurt në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë për të gjithë fëmijët, shqiptarë apo të huaj, të identifikuar në nevojë të menjëhershme për mbrojtje nga Strukturat për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në tërësi, mbështetja është ofruar për 179 fëmijë, nga të cilët, 45 të kategorizuar si të mitur të huaj të pashoqëruar.

Kohëzgjatja e qëndrimit të të miturve në shërbimin e emergjencës varion nga disa orë deri në 2.5 muaj. Gjatë periudhës së qëndrimit në qendrën e emergjencës për fëmijët është ofruar paketa e plotë e shërbimit, përfshirë akomodim, veshmbathje, higjienë, ushqim, kujdes shëndetësor, mbështetje psiko-emocionale. Përgjatë vitit 2022, është ngritur qendra pritëse për fëmijët shqiptarë të riatdhesuar të pashoqëruar të kthyer nga vendet e Bashkimit Evropian, si një bashkëpunim i ASHDMF-së dhe Fshatrave SOS në Shqipëri.

STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



➤ PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Shërbimi Social Shtetëror, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, AMA, KDIMDP, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF-i, ALO 116 111, Nisma ARSIS, Terre des Hommes, World Vision-i, Save the Children, CRCA/ECPAT.

➤ SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik II.2 përbëhet nga dy masa me gjashtëmbëdhjetë aktivitete në masën e parë dhe nëntëmbëdhjetë aktivitete në masën e dytë, nga të cilat, dhjetë janë të buxhetuara në plane veprimi të tjera dhe janë planifikuar me kosto zero. Shpenzimet faktike janë llogaritur vetëm për 42.8% të veprimtarive të planifikuara. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që shpenzimet e planifikuara për të gjitha masat për periudhën 2021-2022, duhej të mbulonin 82.7% të kostove treguese. Diferenca është konsideruar hendek financiar. Institucionet përgjegjëse kanë raportuar për realizimin ose jo të aktivitetit, por nuk kanë raportuar shpenzime për aktivitetet e raportuara si plotësisht dhe pjesërisht të realizuara. Më së shumti në shpenzimet e planit të veprimit në periudhën e miratimit rezultojnë që, për periudhën 2021-2022, shpenzimet faktike janë realizuar në masën 47.0% të shpenzimeve të planifikuara, nga të cilat 62.0% kanë si burim fondet e buxhetit të shtetit. Për të gjithë periudhën 2021-2022, është shpenzuar vetëm 38.9% e kostove treguese të vlerësuara për këtë objektivi specifik. Institucionet/organizatat partnere, kanë financuar 90.0% të shpenzimeve faktike për veprimtaritë e realizuara plotësisht, ndërsa veprimtaritë e realizuara pjesërisht, janë financuar në masën 93.3% nga buxheti i shtetit.

Tabela 6. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	9	6 626 044	10.8%	10 911 989	164.7%	10.0%	90.0%
Pjesërisht i realizuar	6	31 327 177	50.8%	18 045 433	57.6%	93.3%	6.7%
I parealizuar	13	18 767 030	30.4%	-	-	-	-
Pa info	7	4 899 808	8.0%	-	-	-	-

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3

MEKANIZMA DHE SHËRBIME TË SPECIALIZUARA DHE TË INTEGRUARA PËR TRAJNIMIN E FORMAVE TË RËNDA TË DHUNËS, PËRFSHIRË ABUZIMIN SEKSUAL DHE ABUZIMIN DHE SHFRYTËZIMIN ON-LINE

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Numri i shërbimeve të specializuara të ngritura dhe funksionale për fëmijët, viktima të dhunës dhe abuzimit seksual: *(i realizuar, Shkodër dhe Fier)*;
- Numri i rasteve të abuzimit seksual të fëmijët dhe shfrytëzimit on-line, të hetuara nga autoritetet përgjegjëse (30 raste çdo vit): *(i realizuar)*.

MSHMS, me mbështetjen e UNICEF-it, ka ngritur dy qendra me shërbim 'me një ndalesë' për përgjigjen emergjente dhe trajtimin e fëmijëve viktima të dhunës seksuale dhe formave të tjera të rënda të dhunës në Fier dhe në Shkodër.

Ky shërbim do të bëjë të mundur ofrimin e shërbimeve të duhura ndaj tyre, ku fëmijët do të gjejnë mbështetjen e duhur, si edhe trajtimin specifik për problematikat që ata do të kenë. Është hartuar dhe miratuar udhëzimi nr. 564, datë 5.10.2022, "Për miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktima apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës".

Në vijim, është investuar për ngritjen e kapaciteteve të qendrave me një ndalesë, duke ofruar trajnime që kanë pasur në fokus ndarjen e përvojave në punën me fëmijët dhe të rinjtë e traumatizuar nga qendra për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në Zagreb, Kroaci.

Ministria e Brendshme, në kuadër të punës ndërinstitucionale për njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve on-line, në kuadër të zbatimit të Vendimit me nr. 494, datë 30.12.2020, është miratuar Strategjia për Hetimin e Krimeve Kompjuterike dhe po ndjek procesin në vijim për mbrojtjen e fëmijëve on-line.

Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), ka administruar raportimet e dërguara nga ASHMDF-ja gjatë vitit 2021 dhe 2022, me qëllim bashkërendimin e punës dhe trajtimin në kohë reale të raportimeve të bëra në lidhje me abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve në internet. Sipas raportimeve të kryera në portal, në vitin 2021 numërohen rreth 72 raportime, ndërsa në vitin 2022, 25 raportime.

Gjithashtu, në datat 6 - 8 dhjetor 2021, AKCESK-u ka organizuar Cyber Camp, me synim rritjen e nivelit të sigurisë së fëmijëve në mjedisin on-line dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të fushës, përfshirë ata të sistemit të drejtësisë.


Në datat 19-21 Prill 2022, workshop-in novator "Regional Cyber Camp Albania" me rreth 100 të rinj dhe 50 profesionistë nga Shqipëria, Kosova, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Në muajin shkurt të çdo viti, organizohen aktivitete sensibilizuese në kuadër të "Ditës së Internetit të Sigurt".

Në këtë kuadër, në vitin 2022 u organizua një aktivitet sensibilizues me nxënës nga shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, prindër dhe mësues, të ftuar tek Qendra COD në Kryeministri.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËRDHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËRDHE NË PËRQINDJE)



PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Brendshme, AKCESK, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve, si: UNICEF, Terre des Hommes, CRCA/ECPAT, ALO 116 111.

SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik II.3 përbëhet nga një masë me dhjetë aktivitete, nga të cilat dy janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezultojnë të buxheti i planifikuar për aktivitetet e këtij objekti për periudhën 2021-2022, duhej të mbulonte 92.1% të kostove treguese.

Sipas planit të veprimit të miratuar, rezultojnë që për vitin financiar 2021, nuk janë planifikuar shpenzime për 90.0% të aktiviteteve, ndërsa për vitin 2022, shpenzimet e planifikuara janë në masën 92.1% të kostove treguese.

Shpenzimet faktike për të njëjtën periudhë, janë në masën 87.1%, pasi është financuar një pjesë e hendeikut financiar. Për të gjithë periudhën 2021-2022, është shpenzuar sa 80.2% e kostove treguese. Janë mbuluar nga fonde të buxhetit 99.2% e shpenzimeve faktike dhe pjesa tjetër nga fonde të institucioneve dhe/apo organizatave partnere.

Tabela 7. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi i progresit të masave	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	5	26 573 888	86.8%	26 573 888	100.0%	0.5%	99.5%
Pjesërisht i realizuar	2	82 507	0.3%	82 507	100.0%	100.0%	0.0%
I porealizuar	1	-	-	-	-	-	-
Pa informacion	2	3 957 118	12.9%	-	-	-	-

↘ QËLLIMI 3

SISTEMET DHE SHËRBIMET MIQËSORE PËR FËMIJË DHE ADOLESHENTË




QËLLIMI STRATEGJIK 3 NË SHIFRA

Qëllimi i tretë ka në fokus sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë dhe përfshin nxitjen e proceseve e sistemeve miqësore me fëmijët, si: në arsim, shëndetësi, shërbime shoqërore dhe drejtësi. Në këtë aspekt, është synuar më së shumti evidentimi i masave kryesore

të strategjive sektoriale për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha. Institucionet kanë raportuar për 94% të treguesve që lidhen me objektivat specifike të këtij qëllimi strategjik, dhe 63% e tyre janë realizuar plotësisht.

a. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)



b. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)

Numri i treguesve	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I porealizuar
16	10	6	0
100%	63%	27%	0%




c. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NR DHE %)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteteve gjithsej	Nr. i aktiviteteve të raportuara	% e aktiviteteve të raportuara
9	103	78	76%



d. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË RAPORTUARA (NR DHE %)



e. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NR DHE %)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	30	141 963 710	41.63%	145 442 911	102.45%	57.54%	42.46%
Pjesërisht i realizuar	29	151 256 214	44.36%	121 597 128	80.39%	34.66%	65.34%
I porealizuar	18	30 610 662	8.98%	-			
Pa info	26	17 162 061	5.03%				

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1

MUNDËSI TË BARABARTA PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE DHE TË MËSUARIT: NGA FËMIJËRIA E HERSHME, NË ADOLESHENCË

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Përqindja e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë në krahasim me numrin e përgjithshëm të fëmijëve 6 vjeç: *(i realizuar)*;
- Përqindja e braktisjes shkollore: *(pjesërisht i realizuar, nga 0.5 është rritur 0.7, viti 2021)*;
- Numri i fëmijëve që përfitojnë nga mekanizmi i mbështetjes financiare (bursave) për kategoritë e fëmijëve në nevojë (VKM nr. 854)⁸: *(i realizuar)*.

Duke analizuar raportin bruto të regjistrimeve sipas nivelit arsimor gjatë vitit shkollor 2021-2022, vihet re se në kopshte, janë regjistruar rreth 83.1% e djemve dhe 81.1% e vajzave. Niveli i pjesëmarrjes bruto në arsimin e detyrueshëm, është 98.7% për djemtë dhe 92.7% për vajzat.⁹

Numri i fëmijëve të moshës 5-6 vjeç në grupe përgatitore, është 34 011 fëmijë. Grupin e tretë të kopshtit ose grupin përgatitor, e kanë ndjekur 85% e fëmijëve që shkojnë në klasë të parë. Është hartuar dhe miratuar "Korniza e vlerësimit të fëmijëve të kopshtit" dhe, mbi bazën e kësaj kornize, do të fillojë edhe hartimi i instrumenteve

të vlerësimit të përgatitjes për shkollë të fëmijëve në klasat përgatitore (5-6 vjeç). Ndërgjegjësimi i prindërve dhe i komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor bëhet nëpërmjet veprimtarive të mirëplanifikuara në nivel të zyrave vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) dhe institucioneve parashkollore, si dhe të shkollave të arsimit bazë pranë të cilave janë atashuar klasat përgatitore, në bashkëpunim edhe me qeverisjen vendore (realizuar në masën 55%). Aktivitetet ndërgjegjësuese vijojnë dhe haset vështirësi në planifikimin e saktë të numrit të prindërve të fëmijëve me AK në aktivitete ndërgjegjësuese.

Trajnimet e mësuesve parashkollorë të kopshteve mbi metodologjinë e të nxënimit me përqendrim fëmijët dhe zbatimin e kurrikulës me kompetenca, përfshirë ata me aftësi të kufizuar (bazuar në standardet e zhvillimit të mësimin për fëmijët 3-6 vjeç), janë realizuar 100%.¹⁰

Mbështetje financiare/bonus i çerdhes për familje me të ardhura të ulëta për të mundësuar frekuentimin e çerdhes publike, ofrohet në Bashkinë Korçë, derisa familjet të fuqizohen ekonomikisht, kjo pjesërisht edhe në Bashkinë Lezhë dhe në Bashkinë Sarandë.¹¹

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP), është baza e të dhënave (braktisja, aftësia e kufizuar etj.), e cila kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënimit sipas raportimit nga MAS-i nuk është populluar plotësisht nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

8. VKM-ja e cituar i Këshillit të Ministrave si vendimi nr. 666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar. 9. INSTAT/MAS, 2022.

10. 30 prindër të ndërgjegjësuar për rëndësinë e arsimit parashkollor, të cilët frekuentojnë dhe marrin shërbime pranë qendrës komunitare ditore në Bashkinë Tiranë nga Nisma ARSIS.

11. Të dhënat për mbështetjen financiare/bonus i çerdhes, bazohet vetëm në raportimet e 22 bashkive për instrumentin e raportimit për AKDF-në 2021-2026.

Parauniversitar me regjistrin elektronik të notave, mungesave dhe aktivizimit të nxënësve në klasë, bëri të mundur rivendosjen në një platformë digjitale të komunikimit, trinomin “mësues-prind-nxënës”. Sistemi krijon regjistrin digjital, atë elektronik të notave, të mungesave dhe të aktivizimit të nxënësve në klasë, ndërsa prindërit njihen me ecurinë e fëmijëve nëpërmjet një aplikacioni në celular. Ky aplikacion është në fazë zbatimi. Deri në fund të vitit 2021, është mbushur me 479 115 të dhëna individuale që u takojnë kategorive: punonjës (34 225); administratorë (6 094); nxënës (358 776); mësues (31 394); klasa të krijuara (20 635); klasa me kurrikul të zbatuar (17 061); klasa me regjistër të hapur (10 930).

Aktualisht janë rreth 1 245 rrjete profesionale, të cilat janë trajnuar¹² në mënyrë të vazhdueshme nga specialistët e ASCAP-it për udhëzuesin e funksionimit të rrjeteve, për planifikimin e punës vjetore të rrjeteve, për mënyrën e raportimit, si dhe për tema përmbajtësore, si: zbatimi i kurrikulës me kompetenca, përfshirë edhe organizimin e mësimi me dy orë të njëpasnjëshme; zbatimi i kurrikulës në të gjitha klasat; metodologjia e mësimdhënies; portofoli i të nxënësve; vlerësimi i nxënësve; hartimi i testeve; klasat kolektive; mësuesit ndihmës; trajnimi për mësuesit e TIK-ut; ekstremizmi i dhunshëm; lufta kundër substancave narkotike; dokumentacioni i arsimit parashkollor; përdorimi i platformave *on-line*. Gjatë periudhës qershor-shtator 2022 me mbështetjen e UNICEF-it, janë ngritur kapacitetet e 207 drejtuesve të shkollave për politikën e arsimit gjithëpërfshirës dhe përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse në ZVAP-të Dibër, Durrës, Kamëz, Elbasan dhe Krujë. Gjithashtu, gjatë periudhës tetor-dhjetor 2022, janë ngritur kapacitetet e 200 mësuesve ndihmës dhe mësuesve të klasave me të cilët bashkëpunojnë mbi praktikën gjithëpërfshirëse në klasë dhe në shkollë në ZVAP-të Dibër, Durrës, Kamëz, Elbasan dhe Krujë.

Në vitin arsimor 2021-2022, në sistemin arsimor parauniversitar ndjekin mësimin në institucione arsimore publike dhe private duke filluar nga arsimit parashkollor, 4 748 nxënës me aftësi të kufizuara (AK). Rreth 78% e fëmijëve me AK të regjistruar ndjekin arsimin bazë, 10% arsimin parashkollor dhe pjesa tjetër arsimin e mesëm të lartë. Raporti i nxënësve me AK që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës ndaj arsimit special, është përmirësuar nga 75% që ishte në vitin 2014 në rreth 90%. Në vitin shkollor 2022-2023, janë të punësuar në sistemin e arsimit parauniversitar 1 515 mësues ndihmës. Raporti fëmijë/mësues ndihmës gjatë këtij viti, është 3:1.¹³

Në institucionet e arsimit bazë dhe në ZVAP-e krijohen grupe për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në klasën e parë dhe braktisjes, të përbëra nga mësues, përfaqësues të komunitetit të prindërve dhe njësi të vetëqeverisjes vendore. Për këto grupe hartohen plane të veçanta pune dhe ndërtohet një sistem raportimi për rastet e mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollimit. Braktisja për vitin 2021-2022 për arsimin fillor, është 0.59% dhe në arsimin e mesëm të ulët 0.65%. Në total në arsimin bazë është 0.62%. Do të vijojë mbështetja me bursë nga shteti për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por që, në pamundësi financiare, nuk e ndjekin arsimin bazë.

Me VKM-në nr. 511, datë 28.7.2022, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2019-2020”, të ndryshuar, nxënësit nga grupet vulnerabël përveçse me bursë, tekste dhe transport falas, do të mbështeten edhe nga punonjës të veçantë në rolin e mediatorit, që do t’i ndjekin ata në funksion të ndërgjegjësimit, aksesit dhe frekuentimit të procesit mësimor.

12. Në vitin 2021 me mbështetjen e World Vision-it, 152 mësues, mësues ndihmës, staf psiko-social nga shkollat që zbatojnë modelin e Hapësirave Zhvillimore, morën mentorim dhe trajnim (8 trajnime) sipas nevojave specifike të identifikuar dhe kjo ka rritur me 28% më shumë njohuritë dhe aftësitë e tyre në lidhje me praktikimin e qasjeve të arsimit gjithëpërfshirës në klasat e tyre; në vitin 2022, në aktivitete të tilla u përfshinë 221 mësues, mësues ndihmës, staf psiko-social nga shkollat që zbatojnë modelin e Hapësirave Zhvillimore. Ndërsa 31 mësues, kryesisht të Edukimit Fizik, u trajnuan për kurrikulën Edukimi Fizik, përshtatur për fëmijët me AK.

13. Marrë nga kontributi mbi listën e çështjeve përkatëse në kuadër të shqyrtimit të Raportit V dhe VI për Shqipërinë, për të drejtat e fëmijëve, raport i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Drejtoria e Politikave të Arsimit Parauniversitar.

Në fokus është zhvillimi profesional i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, me synim ngritjen e një sistemi mbështetjeje të aftësive profesionale të tyre. Në këtë kuadër, janë ngritur dhe funksionojnë efektivisht 66 rrjete profesionale të mësuesve ndihmës, pjesë e të cilave janë të gjithë mësuesit ndihmës në arsimin parauniversitar. Një raport i detajuar i nevojave për zhvillim profesional të mësuesve ndihmës, ka paraprirë përgatitjen e një kurrikule për zhvillim profesional dhe organizimin e një sërë veprimtarish trajnuese. Me mbështetjen e programit "Asnjë të mos mbetet pas", rreth 1 000 mësues ndihmës kanë ndjekur çdo vit trajnimet e moduleve të akredituara nga MAS dhe janë certifikuar për këto trajnime. Janë hartuar "Kompetencat profesionale të mësuesve ndihmës". Ato ndjekin dhe pasojnë standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe lëndor të mësuesit të miratuara nga MAS, Urdhër nr. 246, datë 24.07.2020. Ky dokument vjen për të plotësuar paketën e zhvillimit profesional të mësuesve ndihmës. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional, i orientuar me standarde dhe tregues të matshëm, do të ndihmojë çdo mësues të "rritet" dhe të vlerësojë performancën e vet.

Planifikimi i buxheteve për sigurimin e materialeve didaktike sipas kërkesave të veçanta të kategorive të ndryshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parauniversitar, është realizuar dhe përfshin përfitimin nga fëmijët me AK: transport falas; trajtim falas në institucionet e arsimit special; tekste falas, sipas VKM-ve përkatëse të përvitshme.

Ndërgjegjësimi/fuqizimi i prindërve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara me qëllim rritjen e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së fëmijës në familje, shkollë, komunitet dhe qasja e tyre në shërbimet kryesore, është realizuar në masën 63%. Gjatë vitit 2021, 110 prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara u pajisën me këshilla praktike për të mbështetur procesin mësimor të fëmijëve të tyre sipas nevojave specifike me mbështetjen e World Vision-it.

Identifikimi në kohë i nxënësve romë dhe egjiptianë që janë në moshë për t'u regjistruar në arsimin parashkollor dhe në atë bazë, si dhe nxitja e përfshirjes në arsimin e detyruar të nxënësve të moshës 6-16 vjeç që nuk janë regjistruar apo e

kanë braktisur shkollën, realizohet çdo vit shkollor në zbatim të marrëveshjes treminstrore për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve në moshën e detyrueshme shkollore. Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë për vitin 2021-2022, ishte: në parashkollor 690 fëmijë, në arsimin bazë 3 648 nxënës në arsimin e mesëm 173 nxënës dhe në total në arsimin parauniversitar, 4 511 nxënës. Mbështetje financiare për nxënësit romë, egjiptianë dhe grupet vulnerabël, është ofruar në zbatim të VKM-së nr. 511, datë 28.7.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2019-2020", të ndryshuar. Për vitin shkollor 2021-2022, përfitues të skemës së teksteve falas, ishin 280 000 fëmijë nga klasa I deri në klasën IX dhe 16 kategori nxënësish përfitues të teksteve falas edhe për klasat X-XII përfshirë nxënësit romë dhe egjiptianë.

Po në kuadër të VKM-së nr. 511, datë 28.7.2022, shkollat që frekuentohen nga nxënës romë dhe egjiptianë po hartojnë e po zbatojnë programe të veçanta passhkollore. Nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë" për vitin shkollor 2021-2022 ka përfshirë 138 shkolla në të gjithë vendin, rreth 7 647 nxënës dhe 808 mësues.

Ky projekt u mundëson fëmijëve, përfshirë edhe ata romë, egjiptianë dhe nga shtresa të margjinalizuara, të bëjnë detyrat e shtëpisë me shokët e tyre dhe nën kujdesin e mësuesve, në mjediset e shkollave, duke krijuar lehtësira për prindërit e fëmijëve, si dhe një barazi dhe socializim për të gjithë fëmijët. Për vitin 2022-2023, nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë" iu bashkuan rreth 150 shkolla të tjera, të cilat janë vlerësuar se plotësojnë kushtet dhe kanë mundësi për ta ofruar këtë shërbim. Shtrirja e këtij shërbimi do të ndikojë ndjeshëm në lehtësimin e familjeve dhe në krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit, kryesisht për nxënësit që vijnë nga shtresat sociale në nevojë dhe grupe vulnerabël.

Institucionet arsimore në nivel vendor, do ta ndjekin me vëmendje këtë proces, duke pasur në fokus shtrirjen e tij sipas nevojave dhe mundësive edhe në shkolla të tjera. Platforma Akademia.al, u krijua me mbështetjen e UNICEF-it. Kjo platformë

është e plotësuar me materiale sipas kurrikulës me kompetenca. Për përdorimin e saj në mësimin *on-line* janë trajnuar rreth 1 200 mësues të TIK-ut. Gjithashtu, janë krijuar platforma të tjera *on-line* që kanë si qëllim përdorimin e përmbajtjeve digjitale në kuadër të kurrikulës me kompetenca, për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe për sigurinë kibernetike, për përdorimin e të cilave janë trajnuar rreth 1 200 mësues të rrjeteve profesionale. Këto platforma përfshijnë mundësimin në çdo kohë të të mësuarit në platforma të sigurta dhe të lehta për t'u aksesuar, të të mësuarit në grup, përgatitjen e studentëve me aftësi teknike, që ata të përshtaten në ekonominë digjitale etj.

Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve për zhvillimin e përmbajtjeve mësimore në internet – ICT është fokusuar në:

- Trajnimin e 125 ToT dhe mësues që japin mësimin e lëndës së TIK-ut në klasën e parë. Ky aktivitet do të vijojë në 2023-shin pas daljes së manualit për ndërgjegjësimin e nxënësve në internet, i planifikuar të hartohet në vitin 2023;
- Krijimin me MOODLE të platformës për trajnimin *on-line* falas për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë me fokus mendimin kritik, zgjidhjen problemore dhe kodimin për trajnimin e rreth 2 000 mësuesve. Në kuadër të kësaj nisme, është realizuar hartimi i manualit dhe krijimi i videove-tutoriale për të lehtësuar aksesimin e portalit dhe përdorimin e të dhënave të portalit;
- Trajnimi i 448 drejtues të rrjeteve profesionale dhe 8 200 anëtarëve të rrjeteve profesionale për përdorimin e platformave *on-line* në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë;
- Gjithashtu, në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve për aftësitë digjitale, janë trajnuar 723 drejtues të rrjeteve profesionale për përdorimin e TIK-ut si metodologji mësimore në shkollat e mesme, të cilët kanë trajnuar rreth 7 000 mësues të tjerë në përdorimin e platformave digjitale në procesin mësimor.

Në vijim të zbatimit të sistemit *on-line* AKELIUS për grupet që janë të vështira për t'u arritur (migrues /

refugjatë) janë trajnuar 300 mësues, gjithashtu janë hartuar dy udhëzues, të cilët mund të aksesohen në faqen e ASCAP-it. Gjatë vitit 2022, Parlamenti i Nxënësve zhvilloi një projekt të hartuar dhe të menaxhuar nga vetë nxënësit e kësaj strukture. Objektivat e këtij projekti ishin: rritja e kapaciteteve të rinjtë mbi vendimmarrjen, aktivizimin dhe advokimin për të drejtat e tyre dhe përgatitjen e një raporti mbi qasjen ndaj problematikave dhe sugjerimeve të rinjve në të gjithë vendin.

Është krijuar rrjeti i shkollave demokratike dhe gjithëpërfshirëse (50 shkolla) nga 75 të parashikuara deri në përfundim të tij dhe rrjetin e mësuesve *Teacher-Net* të këtyre shkollave (rreth 250 mësues), si dhe janë zhvilluar aktivitete me mësues, nxënës, prindër me në qendër edukimin qytetar, qytetarinë digjitale, edukimin mediatik, sigurinë në internet, ndryshimet klimatike, luftën kundër bullizimit etj. Edukimi i qëndrueshëm për qytetarinë demokratike zë një vend të veçantë në sistemin arsimor, si në kurrikulën e edukimit qytetar, ashtu edhe nëpërmjet projekteve, si p.sh.: zbatimi i projektit të përbashkët me Këshillin e Evropës dhe SIDA, "Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri".

Në bashkëpunim me UNICEF-in, është përgatitur udhëzuesi "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë" dhe janë zhvilluar seanca informuese nëpër drejtoritë arsimore rajonale. Udhëzuesi ka synuar t'u vijë në ndihmë shkollave 9-vjeçare për planifikimin e veprimtarive për menaxhimin e situatave emergjente, zhvillimin e aftësive për jetën dhe të një kulture të qëndrueshme të sigurisë në shkollë. Në zbatim të urdhrit 45, datë 7.2.2022, ASCAP-i ndërmori përgatitjen e modulit "Edukimi për menaxhimin e emergjencave dhe sigurinë në shkollë". Moduli synon zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore parauniversitare për të kuptuar rolin e shkollës në edukimin e nxënësve dhe stafit mësimor për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e rrezikut të fatkeqësive natyrore.

Përgjatë vitit 2022, Nisma ARSIS me mbështetjen e UNDP-së ka zhvilluar një cikël *workshop*-esh me stafet e mësuesve dhe ekipet psiko-sociale të katër shkollave në Bashkinë Krujë në kuadër të projektit për përgjigje ndaj emergjencave civile. Rritja e kapaciteteve të stafit pedagogjik dhe psiko-sociale në shkolla, në kuadër të zbatimit të Planit

Lokal të Emergjencave në mbështetje të grupeve vulnerabel duke përfshirë përgjigjen për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Krujë.

Vetëm një numër i kufizuar bashkish kanë ngritur shërbime të dedikuara argëtuese dhe kulturore. Bashkia Korçë ka ngritur tri qendra për fëmijët romë dhe egjiptianë, ku një pjesë e shërbimeve përfshijnë edhe aktivitete argëtuese dhe kulturore për fëmijët në moshë shkollare. Gjithashtu, qyteza e fëmijëve zbaton një shumëllojshmëri programesh për fëmijët duke përfshirë grup-moshën nën 3 vjeç dhe të rinjtë. Bashkitë Kavajë, Sarandë, Mat, Vlorë dhe Berat i kanë funksionale qendrat kulturore. Bashkia Shijak ka nisur procesin e rindërtimit të qendrës kulturore multifunksionale.

Në kuadër të mirërritjes dhe miredukimit të fëmijëve, gjatë vitit 2022, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe ekspertë të UNICEF-it, ka zhvilluar programin “Art, Zeje, Sport”, për aktivitete jashtëshkollare (IOM), i cili filloi zbatimin në 200 shkolla në të gjithë vendin në janar 2023. Ky është një program, i cili synon të ofrojë kurse jashtëshkollare në 8 fusha të ndryshme për fëmijët dhe të rinjtë si: Pikturë; Vegla muzikore; Bujqësia dhe mjedisi ; Zeje; Kor; Teatër; Sport - mirëqenie; Teknologji.

Përtej arsimimit e formimit bazë, për një zhvillim psiko-social, fëmijët kanë të drejtë dhe nevojë për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme kulturore dhe artistike. Programi është miratuar sipas VKM-së nr. 606, datë 14.9.2022, “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit art, zeje dhe sport dhe një shtesë në buxhetin e vitit 2022”, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Programi i nivelit të parë do të jetë menjëherë pas mbarimit të orëve mësimore në mjediset e shkollës së përzgjedhur në bazë të parametrave strukturore nga e hëna në të premte, pa pagesë, duke ofruar kështu përfitime të shumëfishta si për fëmijët, për të zhvilluar talentet e tyre, por edhe për prindërit, duke u mundësuar atyre një mjedis edukativ për fëmijët edhe pas përfundimit të orarit mësimor. Kontributi i buxhetit të shtetit për këtë program sipas VKM-së nr. 606, datë 14.9.2022, ishte 276 milionë lekë me një


shtrirje prej 200 shkollash. Në vijim do të vazhdojë puna për të konceptuar nivelin e dytë, më të përparuar të këtij programi, si dhe të shtrihet në sa më shumë shkolla të tjera në mbarë vendin.

Është finalizuar draftimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet SHSSH-së dhe DAR-ve, për mbështetjen me shërbime të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara, e cila do të nënshkruhet gjatë vitit 2023”.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.1 përbëhet nga pesë masa me 43 veprimtari, nga të cilat dymbëdhjetë janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti për periudhën 2021-2022, duhej të mbulonte 93.0% të kostove treguese.

Sipas planit të veprimit rezultojnë që për periudhën 2021-2022 janë planifikuar shpenzime për 72.1% të aktiviteve. Për të gjithë periudhën 2021-2022 shpenzimet faktike janë sa 57.5% e shpenzimeve të planifikuara. 77.3% e shpenzimeve faktike janë mbuluar nga fonde të institucioneve dhe/apo organizatave partnere dhe pjesa tjetër me fonde të buxhetit të shtetit. Shpenzimet faktike për veprimtaritë plotësisht të realizuara, janë në masën 100.0%, ndërsa për ato pjesërisht të realizuara, janë në masën 66.0%.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF-ja, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF, World Vision-i, Save the Children, CRCA/ECPAT dhe Nisma ARSIS.

Tabela 8. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi i progresit të masave	Numri i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	15	26 567 650	33.8%	26 567 650	100.0%	27.4%	72.6%
Pjesërisht i realizuar	11	28 230 397	35.9%	18 628 950	66.0%	14.3%	85.7%
I parealizuar	6	11 018 115	14.0%	-			
Pa informacion	11	12 819 456	16.3%				

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2

SISTEM I INTEGRUAR I MBROJTJES SOCIALE, I NDJESHËM NDAJ NEVOJAVE TË FËMIJËVE DHE FAMILJEVE

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Numri i fëmijëve që jetojnë në familje që përfitojnë ndihmë ekonomike (trend zbritës): *(i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar (trend rritës): *(pjesërisht i realizuar)*;
- Numri i bashkive që kanë ngritur strukturat NARU sipas përcaktimeve ligjore: *(i paraportuar)*;
- Numri i shërbimeve të ngritura me fondin social për fëmijët: *(i realizuar)*;
- numri i qendrave të shndërruara në shërbime komunitare për fëmijën dhe familjen: *(i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve në shërbim kujdestarie: *(pjesërisht i realizuar)*.

INSTAT-i ka realizuar publikimin e përvitshëm të studimit [“Matja e të ardhurave dhe e nivelit të jetesës në Shqipëri, 2021”](#), përfshirë treguesit në lidhje me fëmijët.

Sot në Shqipëri ofrohen shërbime shoqërore për të gjithë grupet vulnerabel në 391 qendra përkujdesi ose 16% më shumë sesa në vitin 2021. Këto qendra sigurojnë 1,147 shërbime të përkujdesit shoqëror ose 2,3 herë më shumë sesa në vitin 2021 për 36.642 përfitues, individë në nevojë, nga këto, përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë kryesisht fëmijët deri 16 vjeç (47%).

61% e numrit total të shërbimeve janë publike (71% ofrohen nga Bashkitë) dhe 39% jopublike. Rreth 1/3 e shërbimeve ose 29% janë shërbime që sigurohen për “Individë të familjeve në nevojë”, ku përfshihen dhe fëmijët. Shërbimet për “Fëmijë me AK” (22%) përbëjnë grupin e dytë më të trajtuar dhe 8% fëmijë pa kujdes prindëror në qendrat rezidenciale. Këto tre shërbime përbëjnë 60% të të gjitha shërbimeve. Për rreth 80.000 fëmijët nga familjet e skemës së ndihmës ekonomike, ofrohet subvencion për nxitjen e arsimimit dhe vaksinimit, kompensim të energjisë elektrike, shërbime shëndetësore falas si në parësor dhe dytësor, përjashtime nga tarifat në të gjitha fazat e ndjekjes së edukimit dhe përfitime bursash e lehtësira në disa procese.

Janë marrë masa për rritjen e transfertave në para, veçanërisht për familjet me kryefamiljare femra dhe ato me tre e më shumë fëmijë, për të cilat shuma është dyfishuar. Nga kjo shumë e shtuar, kanë përfituar rreth 80 mijë fëmijë. Ndihma financiare për fëmijët pa kujdes prindëror u trefishua. Politika e bonusit të bebes, duke filluar nga viti 2019, mbështet drejtpërdrejt fëmijët dhe familjen, duke garantuar shpërblimin (bonusin) për çdo të porsalindur (40 000 lekë për fëmijën e parë, 80 000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120 000 lekë për fëmijën e tretë). Mbi 42,000 nëna të reja (42767) kanë përfituar nga bonusi i bebes. Nga ky vit po zbatohet një politikë e re për mbështetjen e grave të papuna me tre e më shumë fëmijë nga subvencionimi i shtetit për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në pjesën e parë të vitit 2022, u dhanë dy transfertat në para prej 9 000 lekësh për të zbutur efektet nga lufta në Ukrainë. Për të zbutur ndikimin e inflacionit, është dhënë një mbështetje financiare për përfituesit e ndihmës ekonomike në masën 8 000 lekë për 57 300 familje dhe në masën 20 000 lekë për 6 700 kryefamiljare femra.

Mbështetje e familjeve (me paketa të kompozuar për familjet me shumë fëmijë, përfituese të skemës së ndihmës ekonomike) është ofruar nga organizatat jofitimprurëse në kuadër të programeve mbështetëse në rajone të ndryshme. Gjatë vitit 2022 World Vision-i ka mbështetur me paketa ushqimore dhe artikuj higjieno-sanitarë 2 148 familje. Ndërsa gjatë vitit 2021, numri i familjeve të mbështetura, është 7 417. Terre des Hommes ka mbështetur 230 familje në menaxhim rasti dhe, 3 704 individë në mbështetje gjatë pandemisë, janë ndihmuar me paketa *ad-hoc* ose afatshkurtra. Gjatë viteve 2021-2022, CRCA/ECPAT Shqipëri me mbështetjen e UNDP-së dhe Fondit Social, si dhe me dhurime nga kompanitë ONE Communication, SPAR etj., kanë mbështetur me paketa veshjesh, ushqimesh dhe çanta e mjete mësimore falas rreth 1000 fëmijë në Shqipëri, thuajse gjysmën e tyre në Qarkun Korçë.

Reforma e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar 2020-2022 është në vazhdim, duke kaluar nga modeli i vlerësimit mjekësor në modelin bio-psiko-social dhe është shtrirë në mënyrë progresive në të gjithë vendin. Si pjesë e vlerësimit bio-psiko-social, fëmijët e moshës deri në 18 vjeç vlerësohen nga ekipe multidisiplinare të përbëra nga mjekë dhe punonjës socialë. Vlerësimi i nevojave mbulon edhe nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror dhe fëmijët e vlerësuar, si me aftësi të kufizuar, referohen për të marrë shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkitë dhe zyrat e arsimit dhe formimit profesional të vendbanimit të tyre. Për herë të parë aplikohen kritere vlerësimi bio-psiko-social të veçanta për fëmijët 0 - 18 vjeç dhe kritere për të rriturit. Procesi i ri i vlerësimit bio-psiko-social realizohet përmes përdorimit të Regjistrit Kombëtar Elektronik të Aftësisë së Kufizuar, i cili mundëson transparencë dhe efektivitet në këtë skemë.

Ngritja e kapaciteteve të NJVV-së dhe strukturave përkatëse për të zbatuar dhe për të përfituar nga fondi social është një proces i vazhdueshëm që realizohet nga SHSSH-ja. Ndërkohë, në kuadër të EU4SITA është realizuar metodologjia e optimizimit të shërbimeve sociale dhe do të fillojë shumë shpejt pilotimi në katër bashki të përzgjedhura: Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Elbasan.

Fondet totale të disbursuara për autoritetet vendore përmes Fondit Social në vitet 2020-2022 janë 539 milionë lekë (4.7 milionë euro)¹⁴. Kjo mbuloi 27 shërbime sociale në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në 6 rajone. Nga këto, **13 shërbime u kushtohen fëmijëve** (nga të cilat dy qendra të reja pilot mbështetëse të fëmijëve dhe familjes në 2 bashki) (të paraqitura në tabelën 9), ku përfitojnë 317 fëmijë me aftësi të kufizuara; 225 fëmijë, 168 të rinj dhe 474 familje në shërbime komunitare multifunkionale, 140 fëmijë në strehëza për viktimat e trafikimit; 7 të mitur të huaj të pashoqëruar; dhe 261 familje të mbështetura në Qendrat e Mbështetjes së Fëmijëve dhe Familjes.

Në tre vitet e fundit janë realizuar shumë trajnime mbi menaxhimin e rasteve për profesionistët kyç. Për më tepër, ligjet për kujdesin social dhe decentralizimin, u kërkojnë bashkive që: (i) të vlerësojnë nevojat në territorin e tyre dhe të përgatisin plane lokale të kujdesit social; (ii) të planifikojnë dhe monitorojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit social; (iii) të referojnë dhe të menaxhojnë rastet, duke ngritur Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJNVR) me punonjës socialë. Janë ngritur fuqi punëtore të kualifikuara, mjetet dhe metodat që do të përdoren nga punonjësit socialë dhe proceset e vendimmarrjes të organizuara rreth NJNVR-ve.

14. Për vitin 2020, janë financuar 25 shërbime sociale me 135.908.901 lekë nga buxheti i shtetit. Për vitin 2021, janë financuar 27 shërbime me 185.030.000 lekë. Për vitin 2022, janë financuar nga Fondi Social 31 shërbime me 200.000.000 lekë.

Tabela 9: Lista e shërbimeve të ngritura me Fondin Social

Nr.	Projekti	Përfitues	Numër përfituesish - 2020-prill 2023	Viti i financimit	Përfituesi (individ, sipërmarrje, biznes, OJF, bashki, etj.)
1	Shërbimi i përkujdesit shoqëror, emergjence dhe mbështetjeje për fëmijën dhe familjen	Fëmijët dhe familjet në nevojë	791	2020-2023	Bashkia Durrës
2	Shërbimi i përkujdesit shoqëror Mbështetjeje për Fëmijën dhe Familjen	Fëmijët dhe familjet në nevojë	240	2021-2023	Bashkia Korçë
3	Shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjen	Fëmijët AK+ Prindërit	113	2021-2023	Bashkia Rrogozhinë
4	Shërbim i kujdesit social multifunksional për fëmijët, të rinjtë dhe familjen	Fëmijët dhe familjet në nevojë	354	2021-2023	Bashkia Elbasan
5	Shërbim i kujdestarisë së përkohshme	Fëmijët dhe familjet në nevojë	173	2021-2023	Bashkia Vlorë
6	Shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjen	Fëmijët AK+ Prindërit	520	2020-2023	Bashkia Lezhë
7	Shërbim i integruar komunitar për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara	Fëmijët AK+ Prindërit	656	2020-2023	Bashkia Librazhd
8	Shërbim lëvizës për shtresat në nevojë	kategoritë në nevojë	404	2022	Bashkia Devoll
9	Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror	Fëmijët dhe familjet në nevojë	133	2022-2023	Bashkia Shkodër
10	Qendra Multifunkionale për Zhvillimin e Fëmijëve dhe Fuqizimin e Familjeve	Fëmijët dhe familjet në nevojë	50	2022	Bashkia Sarandë
11	Shërbim lëvizës për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi ndryshe	Fëmijët në nevojë	78	2020	Bashkia Elbasan
12	Shërbim emergjence për fëmijët në situata rreziku	Fëmijët në nevojë	40	2021	Bashkia Maliq
13	Shërbimi i përkujdesit shoqëror ditor-komunitar për fëmijët me aftësi ndryshe	Fëmijët AK	16	2021	Bashkia Kavajë

Në kuadër të asistencës teknike përmes 'Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri' do të kryhet ngritja e kapaciteteve në nivel bashkie, me fokus promovimin e punës sociale si një mjet për menaxhimin e rasteve, e cila lejon koordinimin dhe bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm të përfshirë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social. Asistenca do të mbështesë gjithashtu krijimin dhe zbatimin efektiv të menaxhimit të rastit nga NJNVR-të. Gjatë viteve të fundit, përqindja e fëmijëve 0-17 vjeç në familje kujdestare dhe birësuese ndaj totalit të fëmijëve në kujdes alternativ, ka pësuar një rritje të ngadalshme, por sistematike. Në fund të vitit 2021, numri i fëmijëve 0-17 vjeç në familje kujdestare ishte 370, prej të cilëve 192 ishin djem dhe 178 vajza. Krahasuar me vitin 2020, ky tregues është rritur me rreth 2,5%, ndërsa krahasuar me vitin 2017, rritja arrin në 33%.

Gjatë vitit 2021, rreth 539 fëmijë të grup-moshës 0-17 vjeç, kanë marrë shërbime në qendra rezidenciale: shtëpi fëmijësh dhe qendra zhvillimi. Trendi ndër vite është zbritës. Përqindjen më të madhe të numrit të fëmijëve që kanë marrë shërbime në këto qendra, e zë grup-mosha 6-15 vjeç me rreth 54%. Në gjysmën e parë të vitit 2022, tetë fëmijë u riintegruan në familjet e tyre biologjike, pesë fëmijë u birësuan dhe katërmbëdhjetë të tjerë u zhvendosën në një jetë të pavarur. 19 familje me fëmijë, të vendosura në institucionet e përkujdesit social, janë mbështetur përmes programeve psiko-sociale, ekonomike dhe fuqizimit, ndërsa 308 fëmijë me aftësi të kufizuara mbështeten me shërbime të specializuara celulare, dhe 23 fëmijë në rrezik institucionalizimi mbështeten në familjen e tyre biologjike. Parimet e deinstitutionalizimit dhe fuqizimit të familjes, janë të integruara si parime kyçe të shërbimeve të kujdesit social. PKDI 2020-2023 parashikon deinstitutionalizimin si një proces të vazhdueshëm tranzicioni nga institucionet rezidenciale në shërbime me bazë komunitare, me synimin e reduktimit të numrit të fëmijëve që jetojnë në këto institucione deri në zëvendësimin e plotë të tyre në shërbime kujdestare me bazë familjare. Arritjet e deritanishme përfshijnë: Aktualisht po punohet për transformimin, në dy bashki në Korçë dhe në Vlorë, të shërbimeve rezidenciale për fëmijë 0-6 vjeç në dy shërbime të reja komunitare "Fuqizimi fëmijës dhe familjes", nga i cili kanë përfituar 112 familje, për të parandaluar vendosjen në përkujdes rezidencial të fëmijëve. Dy qendrat mbështetëse për fëmijët dhe familjen në Korçë dhe në Vlorë, për

të cilat u përcaktuan: (i) modele të reja shërbimi brenda strukturës institucionale dhe burimeve financiare dhe njerëzore; (ii) vlerësimi i burimeve njerëzore, plani i zhvillimit dhe paravendosjes; (iii) plani i rialokimit financiar, me koston dhe buxhetin vjetor për shërbime të reja dhe për fëmijë dhe identifikimin e mekanizmave të zbatueshëm për rialokimin e burimeve ekzistuese; (iv) plani i përmirësimit të infrastrukturës pas vlerësimit të nevojave për shërbime të reja. Në Shkodër, një shërbim i ri që synon transferimin e tetë fëmijëve nga institucioni rezidencial publik në shërbime alternative familjare në shtëpi, u mbështet përmes Fondit Social.

U hartuan standardet për dy shërbime të reja të zbatuara në gjashtë bashki (shërbim i specializuar i kujdesit social të lëvizshëm dhe shërbime të sigurta të emergjencës). Përgjatë periudhës nëntor – dhjetor 2022 MSHMS-ja, ASHDMF-ja dhe SHSSH-ja, mbështetur nga UNICEF-i, kanë ofruar një cikël trajnimesh për punonjësit e IPSH-ve në Vlorë dhe Korçë për ngritjen e kapaciteteve për çështje të deinstitutionalizimit duke përfshirë modelin e SHMFF-së, politikat e mbrojtjes së fëmijëve etj. Udhëzuesi i procedurave të ribashkimit të fëmijës me familjen, modeli i kujdesit alternativ profesional dhe modeli i shërbimit mbështetës për fëmijën dhe familjen, janë hartuar nga UNICEF Shqipëri në partneritet me Nisma ARSIS, si modele të zhvilluara nga nevoja për të ndihmuar procesin e ribashkimit të fëmijëve me familjet e tyre biologjike dhe nevoja për ngritjen e shërbimeve mbështetëse në zbatim të procesit të transformimit të IPSH-ve në shërbime komunitare, pas gjetjeve të procesit të vlerësimit të fëmijëve në IPSH-të publike. Këto modele janë miratuar në Komitetin Drejtues të Deinstitutionalizimit. Standardet e institucioneve të përkujdesjes shoqërore për fëmijë, janë miratuar me udhëzimin nr. 631/2022, "Për miratimin e standardeve në qendrat rezidenciale për fëmijët 6-15 vjeç" nga MSHMS-ja. Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve të NJMF-së dhe e punonjësve socialë të NJVNR-së në lidhje me procesin e identifikimit të hershëm të familjeve vulnerabël, referimeve, zhvillimit të planeve të fuqizimit të familjes dhe, si rrjedhojë, e mekanizmit të *gatekeeping*-it, është realizuar përgjatë vitit 2021 nëpërmjet funksionimit të skuadrave vendore të koordinimit, të cilat kanë si qëllim ribashkimin me familjet biologjike.



77.000 fëmijë
kanë përfituar nga Paketa
e mbështetjes sociale



15.000 fëmijë
kanë marrë pagesën nga
Skema e aftësisë së kufizuar

Pagesat e ndihmës sociale:

- Subvencione për 42.000 fëmijë me qëllim vaksinimin dhe ndjekjen e arsimit të detyrueshëm,
- Janë dyfishuar për 15 000 familje me tre e më shumë fëmijë,
- Janë dyfishuar gjithashtu për 5 700 familje me kryefamiljare femra me dy ose më shumë fëmijë,
- Janë trefishuar për 860 jetimë dhe për 1 016 nëna dhe fëmijë viktime të dhunës.


Reforma Kombëtare e Deinstitutionalizimit: numri i fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror ka rënë në mënyrë të vazhdueshme nga 253 në 2019 në 185 në 2022-shin.

Burimi: MSHMS

**STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE
TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)**



**STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE
TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)**



SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.2 përbëhet nga dy masa me 26 veprimtari, nga të cilat katër janë të buxhetuara në plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti për periudhën 2021-2022, mbulojnë 69.8% të kostove treguese dhe rreth 1/3 e kostove treguese, është identifikuar si hendek financiar.

Shpenzimet faktike për periudhën 2021-2022, janë sa 86.8% e shpenzimeve të planifikuara. 66.2% e shpenzimeve faktike, janë mbuluar nga fonde të institucioneve dhe/apo organizatave partnere dhe pjesa tjetër me fonde të buxhetit të shtetit. Shpenzimet faktike për veprimtaritë plotësisht të realizuara, janë në masën 101.7%, ndërsa për ato pjesërisht të realizuara, janë në masën 83.5%.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe organizma ndërkombëtare dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF, World Vision-i, Save the Children, Nisma ARSIS dhe Terre des Hommes.

Tabela 10. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi	Nrumri i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	4	61 730 416	33.4%	62 756 416	101.7%	38.8%	61.2%
Pjesërisht i realizuar	9	116 638 247	63.2%	97 446 641	83.5%	37.1%	62.9%
I porealizuar	4	1 884 705	1.0%	-			
Pa informacion	9	4 304 911	2.3%				

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.3

PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç, nën peshë, në ulje: *(i realizuar)*;
- Përqindja e fëmijëve nën 5 vjeç me rritje të prapambetur për moshën, në ulje: *(i realizuar)*;
- Përqindja e fëmijëve që ushqehen ekskluzivisht me qumësht gjiri deri 6 muaj: pjesërisht *(i realizuar)*;
- Numri i njësive të kujdesit intensiv neonatal që zbatojnë standardet e reja të kujdesit të të porsalindurve: *(i realizuar)*.

MSHMS-ja ka hartuar dhe është në proces miratimi të Planit të Veprimit për Shëndetin Riprodhues 2021–2030.

MSHMS-ja ka miratuar 10 protokolle standarde të trajtimit për kujdesin neonatal për përmirësimin e kujdesit shëndetësor neonatal dhe zbatimin e despistimit neonatal për identifikimin e hershëm të sëmundjeve gjenetike të fëmijët dhe çrregullimeve të tjera, me urdhër nr. 727, datë 30.12.2022, si rezultat i vlerësimit dhe udhëzimeve teknike. Mbështetur nga UNICEF-i, shërbimet e neonatologjisë u mbështetën me pajisje mjekësore për Repartet e Kujdesit Intensiv në të dy maternitetet e Tiranës. Rreth 7 000 të porsalindur përfituan nga përmirësimi i cilësisë së kujdesit neonatal në këto maternitete, duke përfshirë 40 të porsalindur pozitivë COVID-19 të shtruar në spital. MSHMS-ja ka realizuar përditësimin e manualit të përdorimit dhe trajnimit të personelit që ofrojnë shërbimin e vaksinimit, mbledhjen dhe hedhjen e të dhënave në sistemin e informacionit shëndetësor të vaksinimit.

Një zhvillim i ri i rëndësishëm në kalendarin e vaksinimit, është ai i vaksinimit të vajzave me vaksinën e virusit papilloma humane (HPV) ka nisur për herë të parë në vendin tonë në nëntor 2022, për t'i mbrojtur ato nga kanceri i qafës së mitrës. Vaksinimi kundër HPV, nis me vajzat e lindura në vitin 2009, në të gjithë vendin. Përgjatë vitit 2022 është realizuar fushata e komunikimit për vaksinimin e HPV-së për vajzat +13 vjeç, shpërndarë 30 000 fletëpalosje për prindërit me informacion mbi rëndësinë e vaksinës HPV dhe 3000 udhëzime për administrimin e vaksinës për profesionistët e shëndetësisë. Si rezultat, 2500 vajza janë vaksinuar, që përbën 80% të popullatës së synuar.

Gjithashtu, për periudhën raportuese në kalendarin e vaksinimit, është përfshirë edhe një vaksinë tjetër, ajo e vaksinës Rotavirus (nga viti 2019) duke e çuar në 12 numrin e vaksinave falas për fëmijët 0-18 vjeç.

Pas përkthimit, përshtatjes dhe kontekstualizimit të bibliotekës së pasur të artikujve, videove dhe lojërave nga një ekip ndërsektorial ekspertësh të shëndetësisë dhe arsimit, testimi të aplikacionit dhe zhvillimit të planit të komunikimit, aplikacioni i prindërve Bebo u lançua nga MSHMS-ja dhe UNICEF-i. Janë arritur 552 ofrues të shërbimeve shëndetësore dhe arsimore me aktivitete të zhvillimit profesional; 4 182 përdorues kanë shkarkuar dhe përdorur aplikacionin Bebo. Numri më i madh i përdoruesve iu qasën artikujve në lidhje me zhvillimin e fëmijëve, ushqyerjen dhe ushqyerjen me gji, shëndetin dhe mirëqenien, si dhe vaksinimin.

MSHMS-ja, ISHP-ja, UNICEF-i, departamentet dhe shkollat rajonale të shëndetit dhe arsimit, kanë bashkëpunuar për të shpërndarë mesazhe të edukimit shëndetësor, për të rritur ndërgjegjësimin për COVID-19 dhe për të promovuar sjelljet higjienike që mbrojnë nga infeksioni. Fushata #TheCareProtects u zbatua në shtatë qytete të

Shqipërisë. 270 mësues në 5 rajone morën njohuri për ushqimin e shëndetshëm dhe parandalimin e mbipeshës dhe obezitetit, duke përdorur module të akredituara trajnimi. 16 200 fëmijë përfituan nga ndërhyrjet në shkollë dhe u arritën me mesazhe komunikimi për parandalimin e mbipeshës dhe obezitetit. Plani operacional i MSHMS-së ndaj emergjencave shëndetësore civile, me qëndër sigurimin e vazhdueshmërisë së shërbimeve për fëmijët dhe adoleshentët, është në proces miratimi. Grupi i punës, i cili është ngritur në vitin 2019, ka hartuar një draft paraprak, por si pasojë e pandemisë COVID-19 është e nevojshme rishikimi i këtij drafti për t'iu përgjigjur më së miri emergjencave të mundshme shëndetësore civile.

Përgjatë vitit 2022, është rritur numri i personelit të shërbimeve psiko-sociale në të gjitha nivelet e kujdesit të sistemit shëndetësor. Janë krijuar 50 qendra socio-shëndetësore dhe janë punësuar 50 psikologë. Në vitin 2023, do të punësohen në sistemin shëndetësor parësor edhe 50 psikologë/punonjës socialë duke e çuar në 100 numrin e qendrave shëndetësore që do të ofrojnë shërbim të integruar socio-shëndetësor. Janë hartuar 2 programe kombëtare dedikuar fëmijëve në shkolla: Programi i Shikimit dhe Programi i Kujdesit Dentar për fëmijët 6-14 vjeç. Gjithashtu, në kalendarin e vaksinimit, është shtuar vakcina e HPV-së për vajzat +13 vjeç.

Përgjatë vitit akademik 2021-2022, në kuadër të Programit për edukimin shëndetësor, me fokus "Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor", program i ndërmarrë nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) në bashkëpunim me UNFPA, në zbatim dhe të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030, janë realizuar veprimtari me fokus parandalimin e dhunës seksuale dhe ndihmesën për ndërhyrjen në kohë, duke krijuar një mjedis të sigurt shkollor. Janë trajnuar 470 mësues.

- Hartimi i programit të trajnimit "Edukimi shëndetësor me fokus edukimin seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor", 2022-2026.
- Hartimi i moduleve të trajnimit "Edukimi shëndetësor me fokus edukimin seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor", 2022-2026.

- Ndërgjegjësimi dhe përgatitja e kapaciteteve kombëtare dhe lokale për zbatimin në shkollë të paketës trajnuese "Abuzimi seksual", 2022-2026.
- Përgatitja e materialeve ndërgjegjësuese me fokus abuzimin seksual, si edhe për qasjen on-line.
- Identifikimi i shkollave që do të shërbejnë si qendra koordinuese për vazhdimësinë e programit "Edukimi seksual si aftësi për jetën në një mjedis të sigurt shkollor" dhe krijimi i këtyre qendrave koordinuese.

MSHMS me mbështetjen e UNICEF-it, përgatiti hartën e shërbimeve të shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët që kontribuan në zhvillimin e Planit të ri të Veprimit për Shëndetin Mendor, duke siguruar fokus adekuat për fëmijët dhe adoleshentët. Harta theksoi aksesin e kufizuar në shërbimet e shëndetit mendor të përshtatura për nevojat e fëmijëve dhe adoleshentëve, mungesën e besimit tek ofruesit e shërbimeve dhe rolin e rëndësishëm të psikologut të shkollës dhe punonjësve socialë dhe lidhjen me shërbimet shëndetësore të shkollës. Ky raport u integrua në vlerësimin gjithëpërfshirës të Planit aktual të Veprimit për Shëndetin Mendor, të përgatitur nga MSHMS-ja dhe partnerë të tjerë. MSHMS-ja ka hartuar Planin e Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve për Shëndetin Mendor 2023-2026 me fokus në shërbimet për të rinjtë dhe adoleshentët. Shkollat janë të mbuluara 100% me psikologë, të cilët trajnojnë stafet e shkollave të tyre për trajnimin e problemeve të shëndetit mendor.

"Le të flasim për shëndetin mendor" u mbështet bashkërisht nga UNICEF-i, OBSH-ja dhe UNRC-ja dhe u zbatua nga Shoqata e Delegatëve të Rinisë Shqiptare të OKB-së. Një seminar kombëtar dhe 6 diskutime me në fokus grupe lokale, u organizuan me të rinjtë në 6 rrethe (Tiranë, Durrës, Kukës, Divjakë, Librazhd dhe Klos) në Shqipëri për të promovuar rëndësinë e të folurit dhe arritjes së ndihmës për çështjet e shëndetit mendor [rreth 88 adoleshentë dhe të rinj (67 femra)]. Ekspertët e shëndetit mendor, lehtësuan diskutimet rreth ankthit, depresionit, sjelljeve vetëdëmtuese, bullizimit dhe varësisë nga substancat përmes diskutimeve ndërvepruese dhe të hapura. Mungesa e informacionit në shkolla, turpi, stigma dhe

mospranimi i sëmundjeve mendore, veçanërisht nga bashkëmohatarët, ishin ndër shqetësimet që vunë në dukje të rinjtë. Një broshurë me mesazhet kryesore për shëndetin mendor, e përgatitur pas konsultimeve ballë për ballë me të rinjtë dhe një sondazh i U-Report-it, u hartua dhe 600 kopje u printuan dhe u shpërndanë gjatë takimeve, me një kod QR për versionin *on-line*. Aftësimin e stafit pedagogjik për trajnimin e problemeve të shëndetit mendor e kanë ndërmarrë psikologët e shkollave sipas MAS-it. Shkollat janë të mbuluara 100% me psikologë, të cilët trajnojnë stafet e shkollave të tyre për trajnimin e problemeve të shëndetit mendor. Projekti "Shkolla për Shëndetin" me mbështetjen e Save the Children, ka në fokus promovimin e ushqyerjes së shëndetshme dhe të stilit të shëndetshëm të jetës. Plani i promocionit 2022-2030, i miratuar, përfshin aktivitete konkrete për mirushqyerjen dhe aktivitetin fizik të fëmijët.

Në aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve mbështetur nga UNICEF-i, morën pjesë rreth 112 mësues, psikologë shkollash, përfaqësues të zyrave arsimore rajonale dhe të ministrive të linjës së shëndetësisë dhe arsimit. Pjesëmarrësit diskutuan modalitetet për zbatimin e kuadrit rregullator për standardet e ushqimit të shëndetshëm dhe tregtimin e ushqimit jo të shëndetshëm për fëmijët, ndanë përvojat e shkollave që punojnë në promovimin e të ushqyerit të shëndetshëm dhe dhanë rekomandime të dobishme për rrugën në vazhdim¹⁵. Sipas MAS-it aktualisht ushqyerja e shëndetshme është e integruar në lëndën Aftësim Teknologjik dhe për klasat 7-9 është trajtuar në lëndën Biologji dhe Edukim Fizik dhe Sporte. Në zbatim të urdhrin të përbashkët mes MSHMS-së, MAS-it dhe MBZHR-së, nr. 336, datë 14.7.2021, "Për miratimin e rregullores për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare", në institucionet arsimore parauniversitare, është në zbatim rregullorja "Për standardet e ushqimit në mjediset e institucioneve arsimore parauniversitare". Rregullorja, në të cilën përfshihet lista e ushqimeve të lejuara dhe

ushqimeve të ndaluara, ka për qëllim garantimin e shëndetit të fëmijës përmes standardeve të ushqimit, si dhe synon të rregullojë në mënyrë të unifikuar standardet e ofrimit të ushqimit në institucionet arsimore parauniversitare. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka bashkëpunuar me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, bashkitë përkatëse, drejtoritë arsimore rajonale dhe vendore, për sa i përket zbatimit të programit të ekipeve sportive në volejball dhe basketboll për vajza dhe djem, për arsimin 9-vjeçar dhe gjimnazet. Në kuadër të këtij programi, është realizuar një rishikim i situatës së identifikimit të talenteve në nivel lokal dhe nevoja për t'u ofruar federatave talente të reja. Janë zhvilluar disa takime konsultative dhe fokus-grupe, si dhe janë marrë në konsideratë statistika të ndryshme nga burime zyrtare dhe janë krijuar zyrtarisht ekipet në çdo qark.

Programi i ekipeve sportive, të dhëna statistikore:

- 284 trajnerë të angazhuar në projekt;
- Pjesëmarrje e afro 10 000 nxënësve nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme;
- Janë pjesë e projektit 231 shkolla me nga 559 ekipe në basketboll dhe volejball për vajza dhe djem;
- Kanë filluar stërvitjet në të gjitha qytetet tri herë në javë nga 90 minuta;
- Është organizuar një event madhështor më 10 dhjetor në "Air Albania", ku morën pjesë të gjithë fëmijët pjesë e projektit dhe shumë të tjerë që mbështesin dhe nxitin shokët e tyre në stërvitje.


Zbatimi i modelit bio-psiko-social për aftësinë e kufizuar, është shtrirë në të gjithë vendin dhe gjatë vitit 2021 dhe 2022 është punuar në drejtim të përmirësimit të kësaj skeme deri në janar 2023, kur filloi zbatimi i plotë në 12 qarqe. Me këtë reformë, është bërë i mundur për herë të parë vlerësimi i aftësisë së kufizuar edhe për fëmijët e grup-moshës 0-2 vjeç.

15. Një manual mbi kuadrin rregullator për ushqimin e shëndetshëm në institucionet parauniversitare, u përgatit nga një grup teknik pune me përfaqësues nga të dyja ministritë dhe 1 000 kopje iu shpërndanë drejtorive arsimore rajonale dhe shkollave në katër fushat e synuara. Për të mbështetur përpjekjet e advokimit dhe kështillimit të politikave për të siguruar kufizime gjithëpërfshirëse për të mbrojtur fëmijët nga ndikimi i dëmshëm i marketingut të ushqimit, një rishikim i legjisllacionit kombëtar, direktivave të BE-së për ushqimin dhe rekomandimeve globale të UNICEF/OBSH-së për zbatimin e të drejtave të fëmijës. Qasja për marketingun e ushqimit, u përgatit dhe u nda me aktorët kryesorë.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



➤ PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF-ja, Ministria e Arsimit dhe Sportit, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF-i, World Vision-i dhe Save the Children.

➤ SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.3 përbëhet nga një masë me 20 veprimtari, nga të cilat vetëm një veprimtari është buxhetuar në një plan tjetër. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti për periudhën 2021-2022, duhej të mbulonin 82.2% të kostove treguese.

Shpenzimet faktike për periudhën 2021-2022, janë sa 78.1% e shpenzimeve të planifikuara. 91.0% e shpenzimeve faktike, janë mbuluar nga fonde të buxhetit të shtetit. Shpenzimet faktike për veprimtaritë plotësisht të realizuara janë në masën 105.6% dhe janë financuar në masën 94.7% nga buxheti.

Shpenzimet faktike janë më të mëdha, pasi është financuar edhe një pjesë e hendekut financiar. Ndërsa shpenzimet faktike për veprimtaritë pjesërisht të realizuara, janë në masën 86.0% dhe vetëm 59.0% janë mbuluar nga buxheti.

Tabela 11. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi i progresit të masave	Numri i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	8	43 477 068	66.3%	45 930 269	105.6%	94.7%	5.3%
Pjesërisht i realizuar	8	6 199 099	9.4%	5 333 066	86.0%	59.0%	41.0%
I porealizuar	3	15 892 076	24.2%	-	-	-	-
Pa informacion	1	37 694	0.1%	-	-	-	-

OBJEKTIVI SPECIFIK 3.4

SISTEM I INTEGRUAR I MBROJTJES SOCIALE, I NDJESHËM NDAJ NEVOJAVE TË FËMIJËVE DHE FAMILJEVE

▾ TREGUESIT KRYESORË NË NIVEL OBJEKTIVASH TË VEÇANTA NËN KËTË QËLLIM STRATEGJIK, JANË:

- Numri i fëmijëve që përfitojnë ndihmë ligjore falas: *(i realizuar)*;
- Numri i rasteve të trajtuara nga shërbimi i provës: *(pjesërisht i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve (14–18 vjeç) të pandehur nën hetim të raportuar nga prokuroria: *(pjesërisht i realizuar)*;
- Numri i fëmijëve të trajtuar me urdhër mbrojtjeje në gjykatë si viktimë të dhunës në familje: *(i realizuar)*.

Të dëmtuarit (viktimat) e veprave penale u referohen fëmijëve (0-17 vjeç), të dëmtuar nga kryerja e një veprë penale. Përgjatë pesë viteve të fundit, 2017-2021, vihet re një trend në rënie i fëmijëve të dëmtuar (viktima) të veprave penale, më i spikatur në vitin 2020. Në vitin 2021, norma e fëmijëve 0-17 vjeç viktimë të veprave penale (për 100 000 fëmijë), ka shënuar vlerën 198 vetë. Në vitin 2021, numri i fëmijëve (9-17 vjeç) të dyshuar për kryerjen e veprave penale, shënoi vlerën 644 për 100 000 popullatë të kësaj grup-moshe, me një rënie të konsiderueshme në krahasim me vitin 2020. Për grup-moshën 9-14 vjeç, numri i të dyshuarve për vepra penale ishte 176, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me një vit më parë.¹⁶

Negociatat e BE-së dhanë mundësinë për të përforcuar komplementaritetin midis *acquis* të

BE-së dhe standardeve të OKB-së, veçanërisht për të drejtën e fëmijëve dhe aksesin në drejtësi. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare, me mbështetjen e UNICEF-it, hartoi një strategji pesëvjeçare për Drejtësinë për Fëmijët dhe Planin e Veprimit 2022-2026. Objekti është më ambicioz se strategjia e mëparshme, duke shkuar përtej konceptit të drejtësisë penale për fëmijët drejt fushave të tjera të drejtësisë, si familja, civile dhe administrative.

Fëmijët viktimë të dhunës në sistemin e prokurorisë, asistohen nga koordinatori për subjektet me status të posaçëm. Ata intervistohen nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, gjithmonë në praninë e koordinatorit, i cili ofron mbështetje psikologjike për viktimën dhe kryen një raport vlerësimi nevojash. Koordinatorët janë të trajnuar në çështjet e dhunës në familje, abuzimeve seksuale, çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të miturve në konflikt me ligjin.

Është hartuar një material informues për njohjen e të miturit me masën alternative të shmangies së parashikuar nga nenet 55 e vijues të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, miratuar me ligjin nr. 37/2017. Këto materiale dhe model-akte, janë miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm dhe janë bërë pjesë e Udhëzimit të Përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021, "Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitar", që Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë.

Janë parashikuar nga MD-ja për t'u realizuar aktivitete, të cilat lidhen me fuqizimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të mbrojtësve ligjorë të zgjedhur ose të caktuar, të punonjësve të shërbimit të përmbartimit gjyqësor, të punonjësve të QPKMR-së, të shërbimit të provës, të ndihmës

16. [INSTAT, 2022](#)

juridike parësore/dytësore falas, të psikologëve ndihmës/asistues, të njësive për mbrojtjen e fëmijëve dhe grupeve teknike ndërsektoriale në bashkitë (Tiranë, Durrës, Shkodër, Kukës, Dibër, Vlorë, Elbasan, Kamëz, Korçë, Lezhë, Pogradec, Fier, Berat, Gjirokastër, Pukë, Lushnjë) dhe përfshirja e tyre në trajnimet e grupeve shumëdisiplinore.

Autoritetet publike në drejtësi dhe profesionistët e sektorëve të tjerë socialë në Pukë dhe Shkodër, janë angazhuar për të menaxhuar rastet e fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin, në mënyrë të koordinuar dhe shumëdisiplinore. Gjithashtu, është investuar në forcimin e kapaciteteve të profesionistëve në drejtim të menaxhimit të rasteve ndërdisiplinore për fëmijët në konflikt/kontakt me ligjin dhe në intervistimin miqësor ndaj fëmijëve.

Është përmirësuar përdorimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave për Drejtësinë për Fëmijët. Rastet e 1898 fëmijëve në proceset e drejtësisë penale janë regjistruar brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2022 dhe numri i përdoruesve të rregullt, është rritur me 76%.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, urdhëroi që të gjitha gjykatat të fusin të dhëna në sistem nga viti 2023. 15 drejtori vendore të policisë, kanë krijuar njësi miqësore të intervistimit për fëmijët¹⁷, në drejtoritë vendore dhe komisariatet e policisë në zbatim të detyrimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, me qëllim që intervistimi i të miturve, pavarësisht nëse janë të dyshuar, viktimë apo dëshmitarë, të zhvillohet në një mjedis që siguron mbrojtjen e të miturve dhe cilësinë e informacionit të dhënë nga fëmijët.

Këto njësi intervistimi, janë ngritur bazuar në Procedurat Standarde për "Njësinë e Intervistimit të të Miturve, standardet teknike dhe procedurat e përdorimit të këtyre mjediseve", t cilat janë miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 715, datë 5.6.2019.

Njësitë janë pajisur me mjete të regjistrimit audio dhe video të intervistës, si dhe sigurojnë kushte miqësore për të miturit në kontakt me policinë. Rregullat për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, janë të përcaktuara në nenin 39 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, "Rregulla të veçanta të pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar".

Gjatë periudhës Tetor 2021- Qershor 2022 janë ndjekur 11 raste (10 djem dhe 1 vajzë, 12-18 vjeç), të të miturve në kontakt/konflikt me ligjin në njësitë miqësore për intervistimin e fëmijëve në komisariatet e Kamzës dhe Komisaratin nr. 6, Tiranë.


Për vitin 2022, në mjediset e komisariateve të policisë në Tiranë, Kamëz, Vorë etj. është ofruar shërbimi psiko-social i Nisma ARSIS përgjatë procesit të intervistimit në komisariatet e policisë për 484 fëmijë, ndër të cilët, 270 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, janë raportuar pranë njësive të mbrojtjes së fëmijëve.

Përdorimi i njësive miqësore për intervistimin e fëmijëve viktimë, autorë dhe dëshmitarë të veprave penale nga policia, prokuroria dhe gjykatat sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare, mbetet ende një sfidë. Në shumë raste, përdorimi i njësive miqësore të intervistimit, vjen si kërkesë e prokurorisë për rastet e fëmijëve në rrezik të lartë, si për shembull, rastet e fëmijëve viktimë të abuzimit seksual.


Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të sistemit të drejtësisë me sistemet e tjera të kujdesit, mbetet një problem. Vetëm një numër i vogël i bashkive kanë zbatuar menaxhimin e rasteve ndërdisiplinore për fëmijët në kontakt me ligjin.

17. 12 njësi miqësore të intervistimit të të fëmijëve janë krijuar nga UNICEF-i në kuadër të zbatimit të programit suedez dhe tre njësi miqësore të intervistimit të fëmijëve ngritur nga World Vision, në partneritet me Nisma ARSIS.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



SHPENZIMET FINANCIARE

Objektivi specifik III.4 përbëhet nga një masë me 14 veprimtari, nga të cilat, dy veprimtari janë buxhetuar në një plan tjetër. Sipas planit të veprimit rezulton që shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti, duhej të mbulonin 83.7% të kostove treguese për periudhën 2021-2022.

Shpenzimet faktike janë sa 85.1% e shpenzimeve të planifikuara për periudhën 2021-2022. Nga shpenzimet faktike, 84.1% janë mbuluar nga fonde të buxhetit të shtetit. Shpenzimet faktike për veprimtaritë plotësisht të realizuara, janë në masën 100.0% dhe janë financuar në masën 84.1% nga buxheti i shtetit.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF-ja, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF-i, Save the Children, Nisma ARSIS dhe Terre des Hommes.

Tabela 12. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi i progresit të masave	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	3	10 188 576	83.6%	10 188 576	100.0%	84.1%	15.9%
Pjesërisht i realizuar	1	188 471	1.5%	188 471	100.0%	100.0%	0.0%
I porealizuar	5	1 815 766	14.9%	-			
Pa info	5		%				

➤ QËLLIMI 4

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË BOTËN DIGJITALE



QËLLIMI STRATEGJIK 4 NË SHIFRA

Qëllimi IV fokusohet në promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale, duke përfshirë sigurimin e aksesit dhe angazhimin e fëmijëve në mjedisin digjital, **në përputhje të plotë** me objektivin 5 të Strategjisë së Këshillit Evropian **për të Drejtat e Fëmijëve. Nxënia dhe kreativiteti në mjedisin digjital nëpërmjet zhvillimit të kompetencave digjitale përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), është parë si një qëllim prioritar**

dhe i **rëndësishëm për fëmijët**, duke vlerësuar si të rëndësishëm në këtë proces, interesin më të lartë të fëmijës nga të gjitha institucionet që kontribuojnë në mjedisin digjital. Institucionet kanë raportuar të gjithë treguesit që lidhen me objektivat specifike, të këtij qëllimi strategjik, dhe realizimi i plotë i tyre, është në shkallën 75%.

a. NIVELI I RAPORTIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)



b. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT (NR DHE %)

Numri i treguesve	Plotësisht i realizuar	Pjesërisht i realizuar	I porealizuar
4	3	0	1
100%	75%	0%	25%



c. STATUSI I RAPORTIMIT TË AKTIVITETEVE (NR DHE %)

Nr. i masave	Nr. i aktiviteve gjithsej	Nr. i aktiviteve të raportuara	% e aktiviteve të raportuara
3	12	10	83%



d. STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË RAPORTUARA (NR DHE %)



e. SHPENZIMET SIPAS STATUSIT TË REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NR DHE %)

Statusi	Numri i aktiviteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	7	7 401 496	62.0%	9 925 872	134.1%	42.2%	57.8%
Pjesërisht i realizuar	2	-	-	-	-	-	-
I porealizuar	1	-	-	-	-	-	-
Pa info	2	4 535 014	38.0%	-	-	-	-

OBJEKTIVI SPECIFIK 4.1

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË BOTËN DIGJITALE

▾ TREGUESIT NË NIVEL MASASH:

- Përqindja e shkollave me infrastrukturën e përshtatshme TIK, përfshirë internetin: *(i realizuar)*;
- Numri i bashkive (2 bashki të reja në vit) që ofrojnë shërbimin e internetit të sigurt për fëmijët dhe familjet në mjedise apo institucione publike: *(i porealizuar)*;
- Numri i bizneseve (2 biznese të reja në vit) të angazhuar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale: *(i realizuar)*;
- Numri i ankesave të shqyrtuara nga AMA mbi shkeljen e të drejtave të fëmijëve: *(i realizuar)*.

Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla dhe mirëmbajtja e saj, është një proces që kërkon mbështetje me personel të specializuar dhe aktualisht, janë vetëm 64% e shkollave me infrastrukturën e përshtatshme TIK, përfshirë internetin.

Zhvillimi i kompetencës digjitale vlerësohet si një aftësi me rëndësi të lartë për tregun e sotshëm të punës dhe zhvillimin e njohurive kompjuterike dhe aftësive të mendimit kritik për fëmijët dhe të rinjtë. Në përmbushje të kompetencave të tij, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, u ngarkua përmes urdhrin nr. 151, datë 30.12.2021 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për kurrikulën e kodimit që në klasë të parë për projektin ‘Analiza e situatës aktuale dhe propozimi i kurrikulave të përditësuara për lëndën e kodimit në arsimin parauniversitar”, të

kryesojë Grupin Ndërinstitucional të Punës dhe të bashkëveprojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, ASCAP dhe AKCESK, për të ndërmarrë këtë veprimtari. Gjatë vitit 2022, qeveria shqiptare, në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), po zbaton projektin ElementIT të kodimit që në klasën I. Projekti ofron një platformë *on-line* (*codemonkey*) për të mbështetur mësimdhënien dhe mësimin e kodimit dhe mendimit kritik dhe logjik për nxënësit e klasave të para në 100 shkolla për vitin shkollor 2022-2023, si dhe trajnimin e mësuesve për kurrikulën e re të TIK-ut. Synimi afatgjatë i këtij projekti, është riformatimi i të gjithë kurrikulës së lëndës së Teknologjisë së Informacionit, duke përfshirë këtu dhe kurrikulën aktuale që ndiqet nga klasa e katërt deri në të nëntën, por edhe në shkollë të mesme.

Kurrikula e klasës së parë, siguron që fëmijët të kenë mundësi të përfitojnë aftësitë e nevojshme për të përdorur kompjuterin e për t’u orientuar me pjesët e ndryshme të tij, të mësojnë bazat e programimit nëpërmjet një platforme që u mundëson që, bashkë me mësuesit, të ndjekin aventura të ndryshme të kodimit e të zhvillojnë aftësi të mendimit kritik, algoritmik dhe logjik.

Deri më tani, janë instaluar 100 SMARTLab-e në 100 shkolla të arsimit bazë. Janë trajnuar deri tani 110 drejtues rrjetesh profesionale lidhur me planin e rrjetit, aktivitetet që do të kryejnë gjatë këtij viti shkollor, si dhe në përdorimin e platformave *on-line*. Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë (STEM) është një kurrikul që bazohet në idenë e edukimit të nxënësve dhe studentëve në të katërta disiplinat, për një qasje ndërdisiplinare dhe të zbatuar. Gjatë vitit shkollor 2021-2022, MAS-i, UNICEF-i dhe fondacioni Vodafone Albania, në kuadër të projektit ka realizuar trajnimin e mësuesve dhe pajisjen e 24 shkollave 9-vjeçare me 840 “tabletë” dhe 48 “smart boards”, si dhe internet të shpejtë. Janë krijuar 20 “laboratore”

STEM (pajisje të thjeshta elektronike, kit-e robotike dhe grupe trajnimi për metodologjinë e projektit) për 258 nxënës. Trajnimi i të paktën 100 vajzave në STEM, është kryer në këtë periudhë. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), ka zhvilluar fushatën kombëtare "Edukimi digjital, luaj dhe mëso – Happy On-life". Kjo nismë ka qëllim të nxitë te fëmijët dhe të rinjtë të menduarit kritik dhe të mësojnë për përdorimin e sigurt të të dhënave personale në mjedisin digjital. Kjo lojë është ideuar dhe është përgatitur nga Qendra Kërkimore Evropiane. Në bashkëbisedim me pjesëmarrësit (nxënës e mësues), janë ndarë informacione dhe këshilla praktike për mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave personale, sidomos në përdorimin e rrjeteve sociale. Deri në dhjetor 2021, janë organizuar 55 takime në qytetet të ndryshme të Shqipërisë, me pjesëmarrjen e 1 000 nxënësve të klasave të 6/7/8-ta, si dhe mësues të lëndëve të gjuhës angleze, informatikës apo qytetarisë.

Në muajin dhjetor 2022, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, së bashku me Institutin e Nxënësve që nuk Dëgjojnë dhe Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit institucional. Ky dokument ka për qëllim të nxitë aksesin në informacionin publik dhe mbrojtjen e të dhënave personale për këtë komunitet, si dhe të rritë ndërgjegjësimin për ushtrimin në praktikë të të drejtave të tyre, përfshirë edhe mjedisin digjital. Për zbatimin e objektivave të parashikuara në këtë marrëveshje, janë parashikuar edhe fondet përkatëse në buxhetin e Zyrës së Komisionerit. Me mbështetjen e UNICEF-it dhe në bashkëpunim me stafet e NJVV-ve është realizuar shtrirja e modelit BiblioTech pranë bibliotekave të qytetit për aftësimin digjital dhe mbrojtjen *on-line* në Shkodër, Tiranë dhe Korçë. Është realizuar trajnimi i 100 stafeve të bibliotekave vendore dhe është hartuar kurrikula e aftësimin digjital pranë bibliotekave.

Në vitin 2022, WVA-ja së bashku me partnerët lokalë (kryesisht stafe shkollore dhe profesionistë

të NJMF-së në bashki) ka nxitur angazhimin e rreth 1 210 fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete ndërgjegjësuese me qëllim parandalimin e rrezikut të shkaktuar nga përdorimi i internetit. Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të javës së internetit të sigurt.

Stafi psiko-social në shkolla e në zyrat arsimore përkatëse, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në bashkitë Kavajë, Selenicë, Shijak dhe Vaun e Dejës, kanë zhvilluar aktivitete psiko-sociale të ndryshme në lidhje me ndërgjegjësimin e fëmijëve mbi dhunën kibernetike, si edhe për një përdorim të sigurt të internetit. Gjatë vitit 2021-2022 iSIGURT.al (Linja Kombëtare për Internet të Sigurt), në bashkëpunim edhe me ALO 116-111, ka informuar më shumë se 2 000 fëmijë dhe adoleshentë mbi rreziqet *on-line*, përfshirë edhe dhunën seksuale. Një udhëzues i ri për fëmijët, është duke u përgatitur, për t'u mësuar atyre se si dhe ku mund të raportojnë, kur përballen me incidente dhe pasiguri në internet.

Në zbatim të planit të veprimit të "Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025" AKCESK-u ka kryer disa trajnime dhe fushata sensibilizuese për promovimin e të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. AKCESK-u është institucioni i parë që u angazhua për pilotimin e projektit global të Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit dhe partneritetit me UNICEF Albania "Krijimi i një mjedisi digjital të sigurt dhe fuqizues për fëmijët". 37 trajnime¹⁸ (750 pjesëmarrës) janë realizuar në këtë kuadër me aktorët e industrisë, përfaqësues nga institucionet publike në 12 qarqe të vendit, nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qyteteve Patos, Roskovec, Belsh, Divjakë, Librazhd, Mallakastër, Dimal, Përrenjas, Selenicë dhe Kuçovë si dhe prindërit dhe mësuesit e Shkollave të Mesme dhe 9 vjeçare në Babrru, Kamëz, Paskuqan, Vorë, Kavajë, Kukës, Shkodër, Has, Vau i Dejës, Fushë-Arrëz, Pukë, Tropojë, Dibër, Klos, Burrel, Bulqizë.

AKCESK-u ka hartuar gjithashtu dy manualë edukues për fëmijët dhe mësuesit, me informacione mbi sigurinë e fëmijëve në internet. Gjithashtu, janë realizuar tri video ndërgjegjësuese, të cilat

18. Informacion i detajuar nga trajnimet, gjendet në linkun: <https://cesk.gov.al/aktivitete/itu/Trajnime%20per%20sigurine%20ne%20internet.pdf> Gjithashtu, rezultatet e trajnimeve dhe vlerësimi i impaktit për target-grupe të ndryshme, gjenden në linkun: shorturl.at/moEL9.

janë publikuar në mediat sociale të autoritetit dhe më gjerë, duke arritur një audiencë prej 6000 përdoruesish unikë *on-line*.¹⁹ AKCESK-u ka hartuar gjithashtu, edhe një mesazh të unifikuar mbi kujdesin që duhet të kenë prindërit dhe fëmijët me shpërndarjen e të dhënave personale *on-line*.

ASHDMF-ja ka organizuar trajnimin e 150 PMF-ve dhe gazetarëve në 10 bashki. Rezultatet janë prezantuar në Forumin Kombëtar për Median, "Roli i medias në raportimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve" i zhvilluar në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audio-vizive (AMA), MSHMS-në, Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe CRCA/ECPAT-in.

AMA, në prill të vitit 2022, ka nisur procesin e rishikimit të kodit të transmetimit, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë mbrojtjes së fëmijëve përmes parandalimit të promovimit në emisione apo programe audio-vizive të dukurisë së bullizimit, abuzimit seksual, dhunës fizike e verbale, si dhe mbrojtjes së fëmijëve nga reklammat për produkte ushqimore të dëmshme dhe produktet e duhanit.


Ndërkohë, në datën 5 tetor 2022 në Tiranë, në këtë kuadër u organizua tryeza tematike kushtuar fëmijëve, me temë "Respektimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës në transmetimet audio-vizive", me pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimit mediatik audio-viziv (OSHMA), OSHC me fokus të drejtat e fëmijëve. Seksioni për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve është pjesë diskutimi edhe e të gjitha tryezave gjeneraliste që parashikon procesi i rishikimit të kodit të transmetimit, i cili parashikohet të përfundojë në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2023.

Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar, me kujdes dhe profesionalizëm, ankesat e dërguara në AMA. Gjatë vitit 2021 janë shqyrtuar rreth 300 ankesa, 35% e të cilave ishin me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre²⁰.

STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



STATUSI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE TË VEPRIMIT (NË NUMËR DHE NË PËRQINDJE)



19. Video me këshilla për fëmijë: shorturl.at/klnP7.
Video me këshilla për prindër dhe edukatorë: shorturl.at/hmwl2.
Video me këshilla për industrinë: shorturl.at/gkALO.

Impakti i videove dhe rezultatet e fushatës *on-line*, janë publikuar në raportin: shorturl.at/erwHJ.

20. Raporti vjetor 2021 i AMA-s: <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/RAPORTI-VJETOR-I-AMA-s-2021-1.pdf>.

SHPENZIMET FINANCIARE

Objekti i specifik IV.1 përbëhet nga tri masa me 12 veprimtari, nga të cilat shtatë veprimtari, janë të buxhetuara në dy plane të tjera. Sipas planit të veprimit, rezultojnë që shpenzimet e planifikuara për aktivitetet e këtij objekti, duhet të mbulonin 83.7% të kostove treguese për periudhën 2021-2022.

Shpenzimet faktike janë sa 83.2% e shpenzimeve të planifikuara për periudhën 2021-2022. 57.8% e shpenzimeve faktike, janë mbuluar nga institucione dhe organizata partnere. Shpenzimet faktike për veprimtaritë plotësisht të realizuara, janë në masën 134.1% dhe janë financuar në masën 42.2% nga buxheti. Shpenzimet faktike janë më të mëdha, pasi është financuar edhe një pjesë e hendekut financiar. Ndërsa shpenzimet faktike për veprimtaritë pjesërisht të realizuara, janë zero, pasi janë planifikuar të financohen në plane të tjera.

PARTNERËT E ANGAZHUAR

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ASHDMF-ja, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA, AKCESK-u, si dhe organizma ndërkombëtarë dhe kombëtarë që punojnë në fushën e fëmijëve: UNICEF-i, World Vision-i, CRCA/ ECPAT, ALO 116 111 dhe kompani private, si Vodafone Albania etj.

Tabela 13. Shpenzimet sipas statusit të realizimit të aktiviteteve të veprimit (në numër, vlerë dhe përqindje)

Statusi	Numri i aktiviteteve	Shpenzimet e planifikuara	Shpenzimet në %	Shpenzimet faktike	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Partnerë
Plotësisht i realizuar	7	7 401 496	62.0%	9 925 872	134.1%	42.2%	57.8%
Pjesërisht i realizuar	2	-	-	-	-	-	-
I përealizuar	1	-	-	-	-	-	-
Pa info	2	4 535 014	38.0%				

Çështjet e trajtuara në këtë kapitull, janë ato të raportuara si sfida nga institucionet raportuese të AKDF-së, si edhe problematika të raportuara në publikime të tjera. Çështjet lidhen gjithashtu me aktivitetet e parealizuara dhe janë të organizuara më poshtë sipas qëllimeve strategjike.

Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF), edhe pse ka zhvilluar disa takime për trajtimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve, nuk ka arritur të hartojë një agjendë pune vjetore apo kryerjen e rregullt të takimeve. Përcaktuar edhe si aktivitet në AKDF, KKDMF-ja ka gjithashtu rol në ngritjen e komitetit teknik këshillues me qëllim hartimin e një plani pune/masash për koordinimin e roleve midis MSHMS-së, MASR-së dhe NJVV-së për rritjen e mirëqenies dhe të të nxëniet gjatë fëmijërisë së hershme 0–3 vjeç, komitet që ende nuk është ngritur.

Edhe pse ASHMDF-ja përfaqëson një nga institucionet kryesore përgjegjëse për monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, ajo funksionon ende me të njëjtën organigramë dhe kapacitete njerëzore që nga krijimi i saj. Kjo ka krijuar pengesë në përmbushjen e funksioneve, si edhe në realizimin e aktiviteteve të AKDF-së. Edhe pse është miratuar udhëzuesi i pjesëmarrjes së fëmijëve, monitorimi i zbatimit etik të tij mbetet ende i papërmbushur. Për më tepër, mbetet e rëndësishme ngritja e mekanizmave të përshtatshëm në nivel qendror dhe vendor të përfshirjes kuptimplotë të fëmijëve/adoleshentëve. Edhe pse tepër e rëndësishme, analiza e thelluar dhe vjetore e shpenzimeve financiare me fokus fëmijët, në nivel qendror dhe vendor, nuk ka ndodhur. Për sa kohë që aktorët përgjegjës nuk do të angazhohen në këtë proces, nuk do të jetë i mundur raportimi i plotë i investimeve në vend për fëmijët. Fëmijët janë të prekur drejtpërdrejt nga efektet e ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit. Ende nuk është hartuar raporti analitik i impaktit të

ndryshimeve klimatike dhe të mjedisit të fëmijët në Shqipëri, edhe pse ka disa përpjekje të organizatave për të analizuar dhe për të përfshirë fëmijët në këto praktika. Zëri i fëmijëve në këtë proces është i rëndësishëm dhe do të duhet të konsiderohet në hapat në vijim të realizimit të këtij aktiviteti.

➤ ELIMINIMI I TË GJITHA FORMAVE TË DHUNËS

Ende nuk ka nisur puna për të hartuar planin e komunikimit dhe të materialeve/produkteve mbështetëse për të adresuar normat negative sociale që lidhen me të gjitha format e dhunës/abuzimit ndaj fëmijëve. Mangësi janë evidentuar në ngritjen e programeve të edukimit të prindërve dhe fuqizimit të tyre. Nismat ekzistuese janë vetëm në disa NJVV dhe nuk janë të integruara në shërbime dhe mbështeten kryesisht përmes projekteve. Ende nuk është dakordësuar zhvillimi i metodologjisë dhe i instrumenteve për vlerësimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Edhe pse dispozitat ligjore për mbrojtjen e fëmijëve kërkojnë ekzistencën e një njësie për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki dhe të paktën një punonjës të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve me kohë të plotë në nivel njësie administrative (për 3,000 fëmijë), kjo nuk është realizuar në të gjitha bashkitë. Ligji gjithashtu, kërkon që të gjitha PMF-të të kenë një përvojë në punën sociale. Në disa bashki, mbulimi i shërbimeve të njësisë për mbrojtjen e fëmijëve, bëhet ende nga punonjës që nuk janë të diplomuar në punë sociale ose që kryejnë edhe funksione të tjera. Punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, kanë nevojë për trajnime të specializuara në mënyrë të vazhdueshme bazuar në module dhe programe të akredituara, e mbuluar kryesisht nga programet e organizatave/donorëve. Ende nuk është dakordësuar kostimi i menaxhimit të rastit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve ende nuk ka përgatitjen e mjaftueshme për të trajtuar të gjitha format e ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve. Profesionistët

(nga shëndetësia, policia, arsimi, institucione të tjera në kontakt me fëmijët), pjesë e grupeve teknike ndërsektoriale me rol të rëndësishëm për parandalimin, identifikimin, mbrojtjen, hartimin e planeve individuale të mbrojtjes dhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese dhe riintegruese, janë përfshirë pak në paketa të plota trajnuese për ofrimin e shërbimeve të integruara, duke përfshirë fëmijët viktimë të abuzimit seksual apo formave të tjera të dhunës, të vazhdueshme. Me zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimit të internetit, identifikimi dhe trajtimi i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual në internet, vazhdon të jetë një çështje shqetësuese në Shqipëri. Është raportuar si problematik funksionimi i bashkëpunimit ndërsektorial me aktorë të linjës, si agjencitë rregullatore, sektori privat dhe industrial TIK, hetimi i efektshëm dhe ndëshkimi i autorëve të krimeve kibernetike ndaj fëmijëve. Mbetet më tepër për t'u realizuar ngritja e kapaciteteve të profesionistëve, prindërve, kujdestarëve, fëmijëve dhe të rinjve, parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurta për përdorimin e internetit, forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet, si dhe investime në zgjidhje teknologjike dhe miqësore ndaj fëmijëve. Me ngritjen e dy shërbimeve të reja me një ndalesë në bashkitë Fier dhe Shkodër nga MSHMS-ja për trajtimin e rasteve të fëmijëve viktimë të abuzimit seksual dhe të formave të rënda të dhunës, janë shtuar shërbimet që u përgjigjen nevojave të menjëhershme të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Ka nevojë për më tepër përpjekje për ngritjen e shërbimeve të specializuara dhe të integruara ndërsektoriale për fëmijët e mbijetuar të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të rënda të dhunës së gjatë në kohë. Gjithashtu, mungojnë protokolle për profesionistët për ofrimin e shërbimeve të specializuara mbi bazën e një modeli të konsoliduar, që bën bashkë profesionistët e mbrojtjes së fëmijëve, të institucioneve ligjzbatuese dhe shëndetësore.

➤ SHËRBIMET MIQËSORE NDAJ FËMIJËVE DHE ADOLESHENTËVE

Nga raportimi vihet re se nuk janë realizuar masat që lidhen me hartimin dhe miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kënaqësisë së ofrimit të shërbimeve për të gjitha kategoritë, veçanërisht ato me në qendër fëmijët. Kostimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror, mbetet

ende një sfidë, kryesisht për pushtetin vendor. Po kështu, raportohen sfida në ngritjen e strukturave të vlerësimit dhe referimit të nevojave (NJVNR) në çdo bashki sipas përcaktimit ligjor, si edhe në ngritjen e kapaciteteve të atyre ekzistuese.

Ende nuk është realizuar procesi i vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara të vendosur në institucionet e përkujdesit shoqëror, si dhe ndërmarrja e hapave për të shndërruar IPSH-të në shërbime komunitare me bazë familjen për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Zbatimi i planit të deinsitucionalizimit, ka përfshirë deri tani ngritjen e dy shërbimeve të reja të mbështetjes së fëmijës dhe familjes në bashkitë Korçë dhe Vlorë, dhe është në proces shndërrimi i shërbimit rezidencial në shërbim komunitar, proces që po ndodh me hapa të ngadalhtë. Aftësimi i stafit pedagogjik për trajnimin e problemeve të shëndetit mendor, mbetet ende një shqetësim që ka nevojë të ndiqet në vazhdimësi. Ngritja e kapaciteteve të përfaqësuesve proceduralë për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin sipas përcaktimit ligjor, është një proces që ende nuk ka ndodhur, edhe pse janë caktuar përfaqësuesit proceduralë në nivel bashkie. Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit për fëmijët në konflikt me ligjin, ende është një praktikë që zbatohet kryesisht nga programet e organizatave/donatorëve, por jo me një qasje të unifikuar dhe të qëndrueshme.

➤ FËMIJËT NË BOTËN DIGJITALE

Vetëm 47% e shkollave kanë krijuar një infrastrukturë të përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në shkolla, procesi i ngritjes së infrastrukturës së TIK-ut në shkolla po përparon ngadalë. NJVV-të nuk kanë arritur të krijojnë hapësira publike të përmirësuara me internet të sigurt për fëmijët dhe familjet (qasja Friendly WIFI). Krijimi i këtyre hapësirave të sigurta, ka nisur si një praktikë pozitive në disa bashki, por nuk është vijuar, duke zvogëluar mundësinë që fëmijët të kenë akses në internet falas, por dhe në informacion të filtruar dhe që promovon një mjedis të sigurt digjital. Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për shfrytëzimin e TIK-ut në të gjitha shkollat e vendit, shtimi i SMARTLab-ëve dhe "laboratorëve" STEM, shoqëruar me trajnimin e stafit pedagogjik, është një nevojë në vazhdimësi.

↘ MIRËQEVERISJA

- Integrimi i çështjeve të fëmijëve në agjendën e punës së grupeve të menaxhimit të politikave të integruara, në koordinim me KKDMF-në, si një aktivitet që përforcon vëmendjen ndaj të drejtave të fëmijëve. (MSHMS)
- Ngritja dhe koordinimi i takimeve të donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare në mbështetje të zbatimit të agjendës së fëmijëve dhe çështjeve të fëmijëve, nën drejtimin e KKDMF-së. (MSHMS)
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për kryerjen e rregullt të analizës së buxhetimit dhe shpenzimeve financiare me fokus fëmijët në nivel qendror dhe vendor. (MEF, ministritë e linjës dhe NJQV-të)
- Sigurimi i fondeve dhe i burimeve njerëzore të përshtatshme për ASHDMF-në, me qëllim përmbushjen e funksioneve, sipas ligjit nr. 18/2017. (MSHMS/MEF)
- Monitorimi i zbatimit të udhëzuesit të pjesëmarrjes së fëmijëve. (ASHMDF)
- Krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm të konsultimit të fëmijëve për monitorimin e AKDF-së. (MSHMS dhe MAS)
- Publikimi vjetor i statistikave me fokus fëmijët (INSTAT, ministritë e linjës dhe autoritetet vendore).
- Planifikimi dhe kryerja e anketës MICS, rezultatet e të cilës do të mundësonin edhe matjen e rezultateve të AKDF-së. (INSTAT, ministritë e linjës)
- Ngritja dhe fuqizimi i seksioneve të statistikave në të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor (Ministritë e linjës, NJVV, INSTAT).
- Shtrirja në më tepër bashki e mekanizmit “Bashki miqësore për fëmijët”, për të siguruar vazhdimësinë dhe konsultimin e fëmijëve/adoleshentëve/prindërve, lidhur me proceset e buxhetimit, mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, koordinimit ndërsektorial në planet lokale me fokus fëmijët, si edhe për të përmirësuar llogaridhënien në nivel qendror. (NJVV-të)
- Ndërgjegjësimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe rekomandimeve të komitetit të të drejtave të fëmijës mes gazetarëve, përfaqësuesve të tjerë të medias, institucioneve akademike, sektorit privat dhe popullatës në përgjithësi. (MSHMS/ASHMDF)

➤ ELIMINIMI I DHUNËS

- (1) rishikimi i VKM-së nr. 578, "Për menaxhimin e rastit" për të pasqyruar nevojat e identifikuar nga analiza e zbatimit të saj praktik; (2) rishikimi i VKM-së nr. 111, "Për procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijës" (ASHDMF).
- Hartimi i akteve të reja nënligjore në formën e udhëzimeve dhe marrëveshjeve që lehtësojnë mbështetjen e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si: (1) hartimi dhe miratimi i një udhëzimi ndërinstytucional në lidhje me njoftimin dhe heqjen e materialeve të paligjshme dhe të dëmshme të abuzimit seksual dhe shfrytëzimit të fëmijëve on-line; (2) hartimi i një marrëveshjeje ndërministrorë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në vijim të zbatimit të VKM-së nr. 129, "Ngritja dhe fuqizimi i skuadrave të terrenit për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, përfshirë fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe fëmijëve viktime të trafikimit". (MSHMS)
- Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për kujdesin alternativ" për të mundësuar përparimin e procesit të deinstytucionalizimit dhe të mbështetjes së fëmijëve pa kujdes prindëror. (MSHMS)
- Punësimi i PMF-ve në përputhje me kriteret e ligjit. (NJVV)
- Përmirësimi i kapaciteteve dhe i mbështetjes mentoruese për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, për një menaxhim rasti të fëmijëve në nevojë për mbrojtje me qasje ndërsektoriale në çdo bashki, duke siguruar interesin më të lartë të fëmijës, mbetet në vijim prioritet dhe domosdoshmëri. (ASHDMF)
- Rritja e buxheteve vendore për të mbuluar menaxhimin e rasteve për fëmijët në nevojë për mbrojtje. (NJVV)
- Fuqizimi i vazhdueshëm i mekanizmit të raportimit konfidencial për të gjurmuar rastet e dhunës të përjetuara nga fëmijët në shkolla. (MAS)
- Ngritja e kapaciteteve në shërbimet shëndetësore për të identifikuar, për të raportuar dhe për të menaxhuar rastet e dhunës. (MSHMS)
- Rritja e mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjit, prokurorinë dhe gjyqësorin, për të ofruar mbështetje të specializuar për të identifikuar dhe trajtuar në kohë shfrytëzimin seksual, abuzimin dhe incidentet në rritje të abuzimit seksual të fëmijëve në internet. (Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i lartë i prokurorisë, Prokuroria e Përgjithshme)
- Ngritja e shërbimeve të specializuara ndërsektoriale për trajtimin afatgjatë të fëmijëve viktime të abuzimit seksual dhe të formave të rënda të dhunës. (MSHMS)
- Hartimi i protokollit për trajtimin e fëmijëve viktime të abuzimit seksual dhe të formave të tjera të rënda të dhunës me qasje ndërsektoriale dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve. (MSHMS)

SHËRBIMET MIQËSORE

- Rritja e buxhetit për mbrojtjen sociale dhe veçanërisht e fondit social. Ngritja e më tepër shërbimeve në nivel vendor të shërbimeve të nevojshme për fëmijët dhe familjet në nevojë, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara. (MSHMS/NJVV)
- Përmirësimi dhe funksionimi i Regjistrit Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror. (MSHMS/NJVV)
- Angazhimi i plotë i të gjithë aktorëve në përsheptimin e procesit të deinstitutionalizimit, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Mbështetja e procesit të shndërrimit (duke përfshirë programe dhe buxhete) nga institucione të kujdesit shoqëror drejt mjediseve të kujdesit alternativ të bazuar në komunitet dhe në familje. (MSHMS/NJVV)
- Krijimi i një shërbimi të qëndrueshëm, profesional dhe efikas të kujdestarisë, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. (MSHMS)
- Mbështetja e kuadrit të monitorimit të arsimit parashkollor dhe e programit të kurrikulës për fëmijët 5-6 vjeç me plane të detajuara dhe angazhim financiar nga pushteti vendor dhe qendror për zbatimin efektiv të tyre. (MAS)
- Përmirësimi i kapaciteteve për të mbështetur zhvillimin të fëmijëve të moshës 0-3 vjeç, duke përfshirë shënjestrimin dhe koordinimin e shërbimeve, programeve dhe aktorëve. (MSHMS/MAS/NJVV)
- Hartimi dhe zbatimi në nivel vendor i politikave të diferencuara mbi tarifatat për parashkollorët, të vlefshme për fëmijët më vulnerabël. (NJVV)
- Rritja e numrit të mësuesve ndihmës dhe marrja e masave të tjera gjithëpërfshirëse për të siguruar akses progresiv në rritje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në parashkollor. (MAS)
- Funksionimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP). SMIP-i, si baza e të dhënave (braktisja, aftësia e kufizuar etj.) që kombinon të dhënat administrative me rezultatet e të nxënësve, e cila gjithashtu paraqet të dhëna në kohë reale dhe të sakta për pjesëmarrjen dhe cilësinë në arsim, si dhe numrin e fëmijëve që mbeten jashtë shkollës, duhet të avancojë me përparësi. (MAS)
- Identifikimi i fëmijëve dhe i adoleshentëve si një grup objektiv prioritar në strategjinë kombëtare të shëndetit mendor dhe rritja e investimeve në shërbimet e shëndetit mendor me bazë në shkollë dhe në komunitet që synojnë adoleshentët. (MAS/MSHMS)
- Zbatimi i ndërhyrjeve të bazuara në shkollë, përfshirë ato që lidhen me ushqimin e shëndetshëm, aktivitetin fizik dhe imazhin e trupit, përmirësimin e cilësisë ushqyese të ushqimit të ofruar në shkollë dhe shëndetin/mirëqenien mendore. (MAS/MSHMS)
- Buxhetimi i burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e kuadrit normativ të drejtësisë për fëmijë. (MD)
- Marrja e të gjitha masave të nevojshme për të larguar të miturit nga procesi i drejtësisë penale dhe për të forcuar më tej drejtësinë restauruese. (MD)
- Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve që veprojnë në nivel vendor për të administruar drejtësinë miqësore për fëmijët. (MD)

- Përcaktimi i kriterëve të specializimit/certifikimit dhe licensimit të profesionistëve për të trajtuar drejtësinë penale për çështjet e fëmijëve. (Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Sigurisë, Urdhri i Psikologut/Punonjësit Social, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Shërbimi i Provës dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës)
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike në komisariatet e policisë dhe gjykatat për intervistimin miqësor ndaj fëmijëve dhe ngritja e kapaciteteve të profesionistëve për të kryer intervistat në bazë të standardeve. (MB)
- Popullimi sistematik i sistemit të të dhënave në internet që mund të gjurmojë rastet e fëmijëve në zinxhirin e sistemit të drejtësisë. (MD/institucionet e tjera)
- Sigurimi i aksesit të barabartë ndaj ndihmës juridike falas për çdo shkelje të të drejtave të fëmijëve dhe çdo shërbim tjetër që u takon sipas legjislacionit kombëtar. (MD)

👉 FËMIJËT NË BOTËN DIGJITALE

- NJVV-të duhet të shtojnë përpjekjet për krijimin e hapësirave publike me internet të sigurt për fëmijët dhe familjet e tyre, nëpërmjet partneriteteve me sektorin privat, duke shtuar mundësitë për akses në internet falas dhe informacion të filtruar. (NJVV)
- Ndërgjegjësim i aktorëve publikë, i prindërve në veçanti, përmes bisedave, tryezave, debateve mbi rëndësinë e zhvillimit digjital të fëmijëve dhe pjesëmarrjes së tyre për zhvillimin e shoqërisë, duhet të jetë një proces që duhet të ndiqet në vazhdim nga profesionistët në disa sektorë (NJMF, qendrat sociale, shkolla etj.).

SHTOJCA

↘ SHTOJCA A.

Lista e institucioneve të përfshira në raportim

INSTITUCIONE NË NIVEL QENDROR:

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Ministria e Arsimit dhe Sportit
3. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
4. Ministria e Brendshme
5. Ministria e Drejtësisë
6. Ministria e Kulturës
7. Ministria e Mbrojtjes
8. Ministria e Financës dhe Ekonomisë
9. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
10. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve
11. Shërbimi Social Shtetëror

INSTITUCIONE TË PAVARURA

1. AKCESK
2. AKEP
3. AMA
4. Avokati i Popullit
5. INSTAT
6. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
7. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE:

1. ALO 116 111
2. CRCA/ECPAT
3. Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS
4. Observatori për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
5. Save the Children
6. Terre des Hommes
7. World Vision Albania
8. UNICEF Albania

INSTITUCIONE NË NIVEL VENDOR:

1. Belsh
2. Berat
3. Durrës
4. Fushë-Arrëz
5. Kavajë
6. Klos
7. Kolonjë
8. Korçë
9. Lezhë
10. Malësi e Madhe
11. Maliq
12. Mat
13. Peqin
14. Pukë
15. Pustec
16. Sarandë
17. Selenicë
18. Shijak
19. Skrapar
20. Tiranë
21. Vau i Dejës
22. Vorë

SHTOJCA B. Instrumentet e përdorura

Model i instrumentit për matjen e ecurisë së aktiviteteve për institucionet

Institucioni Përgjegjës:												
QËLLIMI I POLITIKËS I: Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përbushjes së të drejtave të fëmijëve												
Objektivi specifik I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përbushjes së të drejtave të fëmijëve												
Aktiviteti / parashikuar në Agjendë	Niveli i përfundimit të aktivitetit, si parashikuar në Agjendë	Aktori kryesor / parashikuar në Agjendë	Progresi për periudhën raportuese (Zgjidhje/rishtimi tek nga nga variantet: Përfundim i realizuar, Përfundim i realizuar, i përfunduar)	Partnerët e tyre të angazhuar në zbatim	Përshkrimi i arritjeve më të mëdha të realizimit të masës (Prova)	Nëse keni zgjedhur 'Pjesërisht e realizuar' ose 'Përfundim i realizuar' për shkak të arsyeve të tilla si: përfundim i punës dhe/ose arsyet për nuk është realizuar aktiviteti.	Kosto Indikative		Buxheti planifikuar		Shpenzimet	
							2021 (në mijë €)	2022 (në mijë €)	2021 (në mijë €)	2022 (në mijë €)	2021 (në mijë €)	2022 (në mijë €)
1.1.1 Funksioni i strukturave në nivel qendror dhe vendor, përgjegjës për hartimin, koordinimin dhe monitorimin e strategjive dhe masave ndërsektoriale që kanë ndikim në jetën e fëmijëve												
1.1.1.1 Integrimi i qëllimeve të fëmijëve në agjendën e punës së Qeverisë të Ministrimit të Përbashkët të Mbrojtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve, në koordinim me												
1.1.1.1.1 Niveli dhe koordinimi i takimeve të organizatave ndërkombëtare në mbledhjen e stafit të Agjencisë së Fëmijëve dhe plotësimi të fëmijëve nga donatorët e AKDF-it												
1.1.1.1.2 Funksioni i kapaciteteve të ASHMDP-it, përfaqësimi i strukturave dhe zbatimi i kapaciteteve të stafit.												

Udhëzues për raportimin mbi ecurinë e aktivitetit/masës

a. Raportimi mbi ecurinë e aktivitetit të parashikuar në Agjendë	Ky instrument kërkohet nga ana e çdo institucioni përkatës pjesë e grupit ndërinstitucional të punës për AKDF të plotësohet formati i vetë-vlerësimit. Si e konsideroni progresin e bërë deri tani? Për çdo aktivitet në këtë instrument ju lutem zgjidhni një opsion nga lista nga menuja e qelizës e cila përmban një legjendë me shpjegimet si në këtë udhëzim (kolona K-L). Në këtë kolonë bëhet përshkrimi i arritjeve më të mëdha të realizimit të masës. Institucioni duhet të ofrojë vetëm informacione strategjike për realizimin e masës, i cili do të ndihmojë për të përcaktuar realizimin e rezultatit. Arritjet duhet të mbështeten me prova, në qoftë se është e mundur (p.sh., të dhëna statistikore, krahasime, etj.). Duhet të shmanget informacioni rutinë dhe administrativ (numri i takimeve të organizuara, grupet e punës të ngritura, etj.,). Për shembull, në qoftë se ligji është përgatitur si realizim i masës, atëherë arritjet duhet të shpjegojnë se çfarë do të ndryshojë si pasojë e tij duke përfshirë shkurtimisht të mirat kryesore të ligjit dhe jo thjesht të deklarohet fakti se është përgatitur një ligji dhe koha kur ai është përgatitur. Informacioni i paraqitur në këtë kolonë duhet të justifikojë statusin e realizimit. Kjo kolonë plotësohet nga një institucion përkatës.	Plotësisht i realizuar	Masa 'plotësisht i realizuar' është masa, objekt i të cilit është realizuar plotësisht, siç përcaktohet në planin e veprimit.
		Pjesërisht i realizuar	Masa 'pjesërisht e realizuar' është ajo masë e cila është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 %.
		Parealizuar	Masa 'parealizuar' është ajo masë e cila është realizuar në shkallën 0 deri në 50 %

Model i instrumentit për raportimin mbi treguesit e objektivave strategjikë

Institucioni Përgjegjës: MSHMS - Shendetesia					
Objektivi specifik I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përbushjes së të drejtave të fëmijëve					
Treguesi	Baseline	Targeti 2026	Statusi i treguesit	Komente shtesë	Komente orientuese
Numri i politikave, planeve dhe programeve në nivel qendror të informuara nga analizat e të dhënave të fëmijëve (në fushën e shëndetësisë)					Listoni të gjithë planet, strategjitë, programet e mbështetura në analizin dhe statistikën e fëmijëve
Objektivi specifik II.2: Funksionimi i një sistemi gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për mbrojtjen e fëmijëve					
Treguesi	Baseline	Targeti 2026	Statusi i treguesit	Komente shtesë	Komente orientuese
Numri i akteve normative të hartuara/rishtuara, në konsultim me grupet e interesit dhe fëmijët, dhe në linjë me standardet ndërkombëtare		të paktën 10			*shënoni kolona E, cila është vlera / statusi aktual i treguesit. * shënoni tek Kolona F informacion shtesë nëse treguesi nuk keni info, nëse nuk ka patur ecuri, etj.
Numri i fëmijëve, viktimat të dhunës, regjistruar nga institucionet shëndetësore	Baseline 2018: 21	Target 2026: 5% rritje cdo vit			

